

'06

RAPORT VJETOR





'06
raporti vjetor

© 2007

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa : Rruga e "Perlat Rexhepi", Kati II, Tiranë

Tel : +355-4-247148, 250686

Faks : 355-4-250686

E-mail : amf@amf.gov.al

URL : www.amf.gov.al

Graphic design: Studio Grafike Elsi Kongo

Shtypi: PEGI



Fjala Përshëndetëse e Kryetares	4
Përmbledhje	5
Tabloja Institucionale e AMF	6
1.1 Krijimi i AMF-së	6
1.2 AMF si një Ent Rregullator	8
1.3 Menaxhimi dhe Organizimi i AMF	10
Aktiviteti i AMF	18
2.1 Aktiviteti Rregullues	18
2.2 Aktiviteti Licencimit	21
2.3 Aktiviteti Mbikëqyrës	27
2.4 Marrëdhëniet Institucionale	45
2.5 Teknologjia e Informacionit	49
Fokusi për të Ardhmen	51
Shtojcat	53
A. Struktura Organizative e AMF	53
B. Kuadri Ligjor – Rregullativ në Sektorin Jobankar	54
C. Lista e Institucioneve të Mbikëqyrura	59
D. Tabelat Statistikore	63

Fjala Përshëndetëse e Kryetares

Të nderuar zonja dhe zotërinj,



Është kënaqësi e veçantë të paraqes raportin e parë vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF).

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u krijua nga Kuvendi i Shqipërisë si institucion i vetëm i pavarur rregullator dhe mbikëqyrës i tregjeve financiare jo bankare dhe filloi veprimtarinë e tij në Tetor 2006. Krijimi i AMF-së pasqyroi angazhimin e autoriteteve Shqiptare për rritjen dhe forcimin e rolit të tregjeve financiare jo bankare në sistemin financiar në Shqipëri dhe në ekonominë e vendit në tërësi.

Përafrimi me standardet Europiane në kuadrin e angazhimit të marrë nga Shqipëria nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, zhvillimi dinamik dhe efektiviteti i praktikave të mira të tregjeve kanë shtruar nevojën e rishikimit të kuadrit ligjor që rregullon sektorët e mbikëqyrur si dhe metodologjisë tradicionale të mbikëqyrjes. Hartimi i kodeve harmonike në fushën e rregullimit të tregjeve, i shoqëruar me metodologji moderne të mbikëqyrjes me bazë riskun dhe me ekspertizë gjithnjë në rritje, duke ruajtur një ambjent fleksibël rregullator do të promovojnë zhvillimin e tregut financiar jobankar në mbrojtje të interesave të publikut.

Raporti fokusohet në dy drejtime: ngritja institucionale, nëpërmjet përshkrimit të krijimit, strukturës organizative dhe funksioneve të AMF-së. Në vijim trajtohet veprimtaria e tregjeve financiare jobankare në vitin 2006 dhe hapat e ndërmarra nga institucionet mbikëqyrëse përkatëse e më tej AMF-ja në rregullim dhe mbikëqyrje. Raporti prezanton dhe vizionin e AMF-së për të ardhmen.

Veprimtaria e përshkruar në këtë raport ka qenë një sfidë për gjithë stafin e AMF-së, i cili e ka përballuar me përkushtim. Gjithashtu, anëtarët e Bordit kanë kontribuar me rolin e tyre konstruktiv dhe profesional për ngritjen e një institucioni eficient dhe modern. Shpreh mirënjohjen për gjithë ato që e asistuan dhe e mbështetën AMF-në, duke veçuar këtu Bankën Botërore.

Shpresoj që ky raport të jetë me interes dhe në dobi të lexuesve.

A handwritten signature in black ink that reads "Elisabeta Gjoni". The signature is written in a cursive, flowing style.

Zj. Elisabeta GJONI

Kryetare e AMF

Përmbledhje



Viti 2006 shënon vitin e themelimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Autoriteti konsolidoi funksionet rregulluese-mbikëqyrëse të aktiviteteve financiare jobankare të kryera më parë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Inspektoriati i Instituteve të Pensioneve Private Suplementare. Objektivat e Autoritetit janë mbrojtja e interesave të konsumatorëve, nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jobankare, si dhe sigurimi i respektimit të ligjit. Banka Botërore ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të nismës së Qeverisë për konceptimin dhe ngritjen institucionale të AMF-së.

Tregu i sigurimeve zë peshën kryesore në tregjet financiare jobankare, ndërsa tregjet e letrave me vlerë dhe të pensioneve private janë në hapat fillestare të zhvillimit. Tregu shqiptar i sigurimeve, megjithë sfidat dhe problemet, së fundmi ka qenë subjekt i një tendence pozitive zhvillimi dhe paraqet një potencial të madh për zgjerim cilësor dhe sasior. Ky potencial bazohet në kushtet e favorshme ekonomike, sistemin e përmirësuar të rregullim-mbikëqyrjes, shkallën e ulët të penetrimit të tregut si dhe në një komunitet biznesi dhe popullsi dinamike e lehtësisht të adaptueshme. Është për t'u theksuar interesimi në rritje i investitorëve të huaj për tregun e sigurimeve. Volumi i primeve në 2006 u rrit me 11.95% në krahasim me 2005, kurse totali i aktiveve kapi vlerën e rreth 11,4 miliardë lekëve duke shënuar një rritje në masën 11,69%. Niveli i primeve në 0.50% të PBB-së dhe niveli i aktiveve në rreth 1.3% të PBB-së janë të ulëta në krahasim me tregjet e ngjashme, por gjithësesi këta janë tregues të potencialit për zhvillimin e tregut. Struktura e primeve, megjithëse në përmirësim, përbëhet nga sigurimi i detyrueshëm motorrik në rreth 66% të saj. Sigurimet e jetës zënë rreth 7% të volumit të primeve. Raporti dëme/prime për tregun mbetet në nivel të ulët rreth 35%, ende larg një standardi ndërkombëtar minimal prej 50%. Rritja e nivelit të pagimit të dëmeve është një ndër prioritetet kryesore të AMF-së. Në treg operojnë shtatë shoqëri të sigurimit të jo-jetës, dy shoqëri të sigurimit të jetës dhe një shoqëri që kryen aktivitetet jete dhe jo-jete.

Në tregun e pensioneve private dhe suplementare operojnë tre shoqëri pensionesh. Shkalla e aktivitetit në këtë treg është e kufizuar. Fondi i akumuluar i pensioneve është rreth 13.15 milion lekë dhe numri i aderuesve mbi 2600. Perspektiva e zhvillimit të këtij tregu në të ardhmen është pjesë e një reforme të gjerë për zhvillimin e shtyllës së dytë dhe të tretë të pensioneve. Tregu i letrave me vlerë është i përqendruar në tregtimin me pakicë të letrave të borxhit të emetuara nga Qeveria, ndërsa mbetet ende i pazhvilluar tregu i aksioneve.

Ndër prioritetet kryesore të Autoritetit në të ardhmen janë përmirësimi i kuadrit rregullator duke siguruar një përafrim me direktivat e Komunitetit Evropian, për tre sektorët financiarë nën juridiksion, kalimi në një sistem mbikëqyrje me bazë risku e shoqëruar me futjen në përdorim të platformave të zhvilluara të IT-së, si dhe promovimi i zhvillimit të tregjeve dhe produkteve të ofruara në këto tregje.

Konsolidimi institucional i AMF-së në zbatim të standardeve të një rregullatori financiar mbetet detyrë prioritare gjithashtu.

I. Tabloja Institucionale e AMF-së

1.1 Krijimi i AMF-së

1.1.1 Krijimi i një Enti Rregullator të Unifikuar

Viti 2006 shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të reformimit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të sistemit financiar jobankar. Bazuar në iniciativën e Oeверisë për të reformuar sistemin rregullator financiar jobankar drejt unifikimit në një ent rregullator të konsoliduar, dhe nën këshillën e mbështetjen e ngushtë teknike të BB, në muajin Tetor 2006 u realizua integrimi i enteve rregullatore – mbikëqyrëse për aktivitetin e tregjeve dhe subjekteve në fushën e sigurimeve, tregut të letrave me vlerë si dhe skemave të pensioneve private suplementare. Në këtë kuadër, u arrit unifikimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS), Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV), si dhe Inspektoriatit të Instituteve të Pensioneve Private Suplementare (IIPPS), duke krijuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF), si i vetmi institucion përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e të gjithë aktivitetit që i përket sektorit financiar jobankar në Shqipëri.

Të gjithë elementët përbërës të procesit të unifikimit të rregullatorëve në sektorin jobankar, duke përfshirë hartimin e strategjisë, krijimin e AMF, ngritjen e kapaciteteve institucionale, zgjedhjen e stafit të kualifikuar, si dhe vizionin e Autoritetit për të ardhmen, u realizuan me mbështetjen e vazhdueshme të Bankës Botërore. Ky bashkëpunim vazhdon në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullativ e mbikëqyrës dhe funksioneve të institucionit.

AMF u krijua në bazë të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i cili pas miratimit nga Presidenti i Republikës dhe botimit në gazetën zyrtare, hyri në fuqi më 10.08.2006. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi 7 anëtarët e Bordit të AMF-së më datën 27 Shtator 2006, duke mundësuar fillimin nga puna të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që nga 11.10.2006. AMF është një institucion qendror, i pavarur nga ekzekutivi dhe raporton në Kuvend mbi aktivitetin e ushtruar gjatë vitit paraardhës.

Avantazhet Integritit të Mbikëqyrjes Financiare

Mbikëqyrja e integruar është një përjasje, e cila bazohet mbi supozimin që në një ekonomi globale. Ndryshimet mbi institucionet që ofrojnë shërbime financiare po bëhen gjithnjë e më tepër të vogla dhe shpesh herë shkaktojnë praktika rregullative kontradiktore, të cilat mund të lënë shteg për abuzime apo influenca negative në zhvillimin e tregjeve financiare. Zhvillimi i shpejtë i tregjeve financiare si dhe hedhja në treg e instrumentave e shërbimeve financiare gjithnjë e më komplekse, janë faktorë që jo në pak raste kanë shkaktuar një mbivendosje të fushës së mbulimit të mbikëqyrjes së këtyre tregjeve. Në dekadën e fundit vihet re një tendencë e theksuar e unifikimit të rregullatorëve financiarë, karakteristike kjo edhe për Europën Lindore.

Një strukturë plotësisht e integruar mbikëqyrëse, është më e mirë se një strukturë e fragmentuar për këto arsye:

- Integrimi siguron standarde dhe trajtime të njëjta rregullimi për sektorë të ndryshëm;
- Integrimi ofron sinergjitë midis fushave të ndryshme funksionale të rregullatorit si nga pikëpamja e personelit ashtu edhe e neutralitetit rregullator;



- Integrimi lehtëson më mirë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Integrimi mund të jetë unifikim i plotë, apo në dy struktura rregullatore. Në Shqipëri u ndoq modeli i dy rregullatorëve financiarë (BSH dhe AMF), për t'u rivlerësuar në një kohë të dytë drejt një unifikimi të plotë.

Modelet e Integrit

Eksperiencat e vendeve të zhvilluara kanë treguar se ekzistojnë dy modele të integritit të institucioneve rregullatore të sistemit financiar:

- a. Integrimi Horizontal - struktura organizative e rregullatorit të unifikuar ndërtohet sipas funksioneve të proceseve mbikëqyrëse (mbikëqyrja on-site, off-site, licencimi),
- b. Integrimi Vertikal – struktura organizative ndërtohet sipas sektorëve (sigurimet, investimet, pensionet).

Si analizat teorike, ashtu edhe eksperiencat e deritanishme flasin në favor të një integriti funksional apo “horizontal”, i cili vërtetë në fazën e parë të transferimit ka vështirësi administrimi më të mëdha, por ka një sërë avantazhesh gjatë aktivitetit të institucionit. Në Shqipëri u zbatua modeli “horizontal”, për një integrit funksional.

1.1.2 Integrimi në Rastin e Shqipërisë dhe Modeli i Përzgjedhur

Duke marrë në konsideratë nivelin e zhvillimit të sektorit financiar (sidomos sektorit jobankar) dhe numrin e institucioneve përkatëse rregullatore deri në vitin 2006, arrihet në përfundimin se Shqipëria kishte shumë rregullatorë financiarë. Kështu, funksioni i rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit financiar ndahej midis Bankës së Shqipërisë që mbikëqyr sektorin bankar dhe një sërë entesh rregullatore me statuse të ndryshme që mbikëqyrnin fusha të ndryshme të sektorit financiar jobankar (AMS, KLV, IIPPS). Kjo kishte sjellë fragmentimin e autoritetit dhe përgjegjësisë, diferenca të theksuara në standarde dhe përdorim jo eficient të aftësive rregullatore e mbikëqyrëse.

Krijimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si dhe ndarja e standardizimi i mbikëqyrjes dhe rregullimit të sektorit financiar në dy shtylla kryesore bazuar në sektorin bankar të mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë dhe atë jobankar të mbikëqyrur nga një ent rregullator i integruar (AMF) është zgjidhja më e mirë e përshtatshme për sistemin financiar të vendit. Nga ana tjetër, integrimi i rregullim-mbikëqyrjes së sistemit financiar jobankar do të rrisë premisat për një zhvillim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm të këtij sektori të rëndësishëm të ekonomisë.

Në rastin e Shqipërisë, është zgjedhur “integrimi horizontal”, një kombinim i integritit funksional në nivelet e larta të njësive organizative të strukturës së AMF-së, dhe brenda tyre një ndarje sektoriale. Kështu, departamentet kryesore janë të përcaktuara nga funksionet bazë të institucionit të integruar: departamenti i licencimit, ai i mbikëqyrjes off-site, i mbikëqyrjes në vend, departamenti juridik etj. Brenda tyre janë ndarjet sektoriale, p.sh. licencimet për aktivitetet në sigurime, licencimet për aktivitete të investimeve të letrave me vlerë etj.

1.2 AMF si një Ent Rregullator

Misioni

Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e të gjitha rregullave.

Vizioni

Ne synojmë nëpërmjet ngritjes së vazhdueshme të nivelit të rregullimit dhe mbikëqyrjes në treg, promovimin dhe nxitjen e standardeve të larta për mbrojtjen e konsumatorëve dhe integritetin e të licencuarve, rritjen e efikasitetit dhe stabilitetit të tregut financiar jobankar si dhe përmirësimin e shkallës së profesionalizmit.

Objektivat themelore

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare udhëhiqet nga këto objektiva:

1. Mbrojtja e interesave të konsumatorëve;
2. Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jobankare;
3. Sigurimi i respektimit të ligjit.

Institucionet ne Juridiksion

- Shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo-jetës;
- Shoqëritë e risigurimit;
- Brokerët dhe agjentët e sigurimeve
- Bursa e Tiranës;
- Qendra e Regjistrimit të Aksioneve;
- Ndërmjetësit financiarë të letrave me vlerë;
- Këshilltarët e investimeve;
- Institutet e Pensioneve Private Suplementare


Funksionet Kryesore të AMF

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF janë rregullimi dhe mbikëqyrja:

- a. e tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
- b. e tregut të titujve dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në tituj e që veprojnë në këtë treg,
- c. e tregut të pensioneve suplementare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve suplementare, të ofruara nga institutet private të pensioneve suplementare;
- d. e veprimtarive të tjera financiare jobankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës.



Struktura e Mbikëqyrjes dhe Rregullimit të Sistemit Financiar në Shqipëri



Funksionet bazë rregullative-mbikëqyrëse të AMF-së parashikohen kryesisht në nenet 2 dhe 13 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, dhe pjesërisht në ligjet e fushës (Ligji nr.9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, ligji nr.8080, datë 01.03.1996, “Për letrat me Vlerë”, ligji nr. 7943, datë 01.06.1995, “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”). Megjithatë një sërë funksione rregullative të përshkruara në ligjet e fushës, adresohen në mënyra të ndryshme për shkak të trashëgimisë së varësive të ndryshme të tri rregullatorëve të mëparshëm. Rishikime ligjore për përcaktimin e qartë të kompetencave për nxerrjen apo propozimin e standardeve, akteve ligjore e nënligjore të fushave përbën një proces në vazhdimësi të integritimit institucional.

1.3 Menaxhimi dhe Organizimi i AMF-së

1.3.1 Aktiviteti i Bordit të AMF

Organi drejtues dhe vendimmarrës i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është Bordi, i cili është një organ kolegjal i përbërë nga 7 anëtarë, tre prej të cilëve, kryetari dhe dy nënkryetarë janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë. Kryetari dhe një nga nënkryetarët e Bordit emërohen për një afat kohor 5 vjeçar, ndërsa nënkryetari tjetër për një afat 4 vjeçar. Kohëzgjatja e mandatit për katër anëtarët e tjerë të Bordit është si vijon: i pari – 5 vjet, i dyti – 4 vjet dhe dy të tjerët – 3 vjet.

Të gjithë anëtarët e Bordit zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Kryetari, dy nënkryetarët dhe dy anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministratve (tre nga këta pesë anëtarë propozohen nga Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit), ndërsa dy anëtarë të tjerë propozohen nga Kuvendi.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare përbëhet nga:

1. zj. Elisabeta GJONI	<i>Kryetare</i>
2. z. Keler GJIKA	<i>Nënkryetar</i>
3. zj. Ermela GUXHOLLI	<i>Nënkryetare</i>
4. zj. Miranda RAMAJ	<i>Anëtare</i>
5. zj. Diana LAMANI	<i>Anëtare</i>
6. zj. Raimonda KARAPICI	<i>Anëtare</i>
7. zj. Silvana BELLO	<i>Anëtare</i>

Gjatë vitit 2006 Bordi ka zhvilluar mbledhje të shpeshta për të përmbushur një sërë detyrimesh ligjore për ngritjen dhe funksionimin institucional të AMF-së, për zbatimin e shkrirjes dhe konsolidimit të tre rregullatorëve ekzistues. Njëkohësisht, Bordi bazuar në punën e vlefshme të administratës si dhe këshillimin e BB, ka ndjekur me kujdes zhvillimet e tregut duke ushtruar me përgjegjësi kompetencat për mbikëqyrjen e kujdesshme të tregut, duke marrë një sërë vendimesh të rëndësishme në këtë drejtim.

Aktiviteti i Bordit ka konsistuar në miratimin e një sërë rregulloresh për funksionim apo për tregun, marrjen e një sërë masash administrative, të cilat synojnë disiplinimin e tregut dhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin në këtë treg, miratimin e planit financiar etj. Anëtarët e jashtëm të Bordit kanë dhënë një kontribut të veçantë në fushat përkatëse, duke përkushtuar mjaft kohë dhe energji.

Anëtarët e Bordit të AMF




Zj. Elisabeta GJONI / *Kryetare*




Mr. Keler GJIKA / *Nënkryetar*



Zj. Ermela GUXHOLLI / *Nënkryetare*



Zj. Miranda RAMAJ / *Anëtare*



Zj. Diana LAMANI / *Anëtare*



Zj. Rajmonda KARAPICI / *Anëtare*



Zj. Silvana BELLO / *Anëtare*

Kompetencat Kryesore të Bordit të AMF

1. Harton rregullat për përshkrimin dhe qëllimin e punës së çdo departamenti dhe njësie.
2. Harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së tij.
3. Harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara në ligj.
4. Shpërndan udhëzues të shkruar për interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore.
5. Lëshon, refuzon, pezullon apo heq licencat për ushtrimin e veprimtarisë në tregun financiare jobankar.
6. Kufizon ose ndalon investimet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, kur ato nuk janë në përputhje me raportet rregullatore apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë.
7. Shqyrton kushtet e kontratës së sigurimit, para se ato të hidhen në treg nga operatorët.
8. Miraton pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit.
9. Miraton dhe shpërndan standarde kontabël dhe formatet e njoftimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit.
10. Përcakton politikat e mbikëqyrjes, të kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura dhe të zhvillimit të tregut financiar jobankar.
11. Miraton listën e ekspertëve kontabël për shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jobankare.
12. Miraton çdo vit raportin për industrinë, në lidhje me gjëndjen dhe perspektivën e tregut financiar jobankar.
13. Miraton manualet e inspektimit.
14. Sipas ligjit, merr vendim për fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikëqyrura dhe emëron likuidatorin.
15. Miraton projektbuxhetin dhe raportin vjetor të AMF-sw.
16. Merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit.
17. Vendors për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.
18. Miraton politikën e pagave dhe të shpërblimeve të stafit të AMF-së.
19. Miraton rregulla për emërimin dhe shkarkimin e stafit

1.3.2 Struktura e AMF-së

Struktura e Autoritetit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Bordit të AMF.

Bordi miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet e veçanta dhe përgjegjësitë e departamenteve e të drejtorive, procedurat e komunikimit ndërmjet

tyre, si dhe përgjegjësitë e nëpunësve dhe të punonjësve të tjerë. Në strukturimin dhe organizimin e stafit të saj, AMF është e prirur në drejtim të sigurimit të mjeteve dhe burimeve njerëzore të nevojshme për të arritur një mbikëqyrje dhe rregullim sa më efikas të sektorëve të ndryshëm të tregut financiar jobankar.

AMF e filloi veprimtarinë e saj në Tetor të vitit 2006 me një strukturë të miratuar me VKM Nr. 551, datë

Struktura e AMF

Zbatimi i detyrave dhe përbushja e objektivave sigurohet nga puna e punonjësve të Autoritetit, të cilët janë të organizuar sipas një strukture të miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin e tij nr. 551, datë 2.08.2006 "Për strukturën e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare".



02.08.2006 dhe nje nivel pagash për anëtarët e Bordit me kohë të plotë apo të pjesshme të përcaktuar nga ligji Nr. 9584, datë 17 Korrik 2006, për pagat. Struktura e vitit 2006 e organizimit të AMF-së, me një numër punonjësish prej 37 vetësh, dhe nivel pagash, i cili për shumë punonjës shënoi rënie nga ai i mëparshmi, paraqitet jo i shumë i përshtatshëm për të mbuluar të gjitha funksionet rregulluese që duhet të luajë një ent rregullator, përgjegjës për tregun financiar jobankar, si dhe sfidat e integritimit. Kjo strukturë dhe numri i punonjësve mendohet të përmirësohet në kohë duke filluar që nga viti 2007, në bazë të nevojave dhe të eksperiencës më të mirë.

1.3.3 Aktiviteti Menaxhues

Menaxhimi i AMF-së ka punuar në drejtim të ngritjes dhe fillimit të funksionimit të këtij enti të ri rregullator brenda një kohe të shkurtër. Fillimisht vëmendja e organeve drejtuese të AMF-së u fokusua në përzgjedhjen e një stafi të kualifikuar kryesisht me specialistë që kanë një eksperiencë të gjatë në sektorë të ndryshëm, subjekt i aktivitetit mbikëqyrës të AMF-së. Në këtë kontekst, është bërë kujdes për motivimin e stafit të përzgjedhur dhe është hartuar politika e pagesave dhe nivelit të shpërblimeve, duke u bazuar kryesisht mbi eksperiencën, kualifikimet dhe përgjegjësitë. Megjithë përpjekjet, kufiri i sipërm i pagës së anëtarëve të Bordit me kohë të plotë, krijon vështirësi për mbajtjen e specialistëve të aftë, për shkak të rënies së nivelit të pagave pas unifikimit të rregullatorëve. Paralelisht, AMF hartoi termat e referencës për përgatitjen e një strukture të nevojshme për të përmbushur objektivat e institucionit. Struktura e propozuar nga Bordi AMF-së ka kaluar në Kuvendin e Shqipërisë për miratim.

Një funksion të sigurimit të një mbikëqyrjeje efikase, menaxhimi i AMF-së ka patur asistencën e huaj teknike si dhe bashkëpunimin e ngushtë të donatorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare si Banka Botërore (BB), FSVK në drejtim të hartimit të një strategjie të mirëstuduar për mbikëqyrjen e tregut financiar jobankar në Shqipëri, por jo vetëm. Gjithashtu, nga ana e institucionit i është dhënë përparësi e veçantë paraqitjes dhe prezantimit të AMF-së para publikut dhe grupeve të ndryshme të interesit. Nga ana tjetër, ndonëse e sapo krijuar, AMF ka vazhduar aktivitetin e saj të përditshëm mbikëqyrës duke monitoruar rregullisht tregun financiar jobankar si dhe operatorët që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë treg.

1.3.4 Politikat e Burimeve Njerëzore

Fusha e burimeve njerëzore është e një rëndësie të veçantë, pasi arritja e objektivave të caktuar nga AMF varet nga cilësia dhe motivimi i çdo punonjësi. Oëllimi kryesor në fushën e burimeve njerëzore, gjatë vitit 2006, ka qenë zhvillimi i profesionalizmit të punonjësve dhe motivimi i tyre për arritjen e objektivave të institucionit.

Në këtë kuadër, si pjesë e një projekti të mundësuar nga FSVC (Financial Services Volunteer Corps), Sektori i Burimeve Njerëzore ka patur asistencën dhe mbështetjen mjaft të vlefshme të ekspertëve me eksperiencë të gjatë në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Ky program fokusohej në disa çështje kryesore:

- Zhvillimi i Strategjisë së Burimeve Njerëzore;
- Përcaktimi i linjave të politikave në fushën e burimeve njerëzore;
- Përgatitja e planeve për zhvillimin e stafit përfshirë analizën e nevojave për training;
- Përgatitja e përshkrimit të vendeve të punës në përputhje me strukturën organizative të AMF;
- Ngritja e një strukture pagash që lejon fleksibilitetin e pagave bazuar dhe në performancën në punë.

Politikat kryesore të burimeve njerëzore për vitin 2006 janë fokusuar kryesisht në drejtim të nxitjes dhe motivimit në punë, përzgjedhjes së stafit të kualifikuar, si dhe rritjes së kapaciteteve nëpërmjet trainimeve për punonjësit.

Rekomandime të ekspertëve të FSVC për çështje të rëndësishme në fushën e Burimeve Njerëzore

Rekrutimi

- Krijimi i një pakete më atraktive për rekrutimin e njerëzve në punë, e cila përveç pagës, të përfshijë mundësi për zhvillimin e karrierës, trajnime profesionale, kushte dhe mjete më të mira pune dhe komunikimi, vlerësim dhe motivim në punë (stimujt) etj.
- Hartimi dhe aplikimi i testeve të thjeshta dhe të arsyeshme për procesin e rekrutimit.
- Përgatitja e një plani për zgjerimin gradual të numrit të punonjësve dhe përcaktimi i sektorëve më prioritarë ku kërkohet më tepër staf.

Vlerësimi i Performancës

Ndërtimi i një forme të thjeshtë por të efektshme të vlerësimit të performancës dhe disenjimi i lidhjes së saj me pagën.

Zhvillimi i Karrierës

Gjetja dhe dhënia e mundësive për të zhvilluar kapacitetet profesionale të specialistëve që punojnë në AMF, nëpërmjet trajnimeve jo vetëm brenda por edhe jashtë vendit. Kjo është një mundësi e mirë dhe për rritjen e motivimit.

Nxitja në punë e punonjësve

Objektivi themelor i një politike të tillë synon të nxisë dëshirën e punonjësve për të punuar dhe rritur cilësinë e punës. Elementi bazë i motivimit në punë është shpërblymja material në formën e pagës dhe shtesave mbi pagën. Në këtë kontekst, do të bëhet ristrukturimi i sistemit të pagave, i cili do të mbështetet nga një vlerësim i detajuar i vendeve të punës bazuar në vlerësimin e performancës së çdo individi.



Në përgjithësi është zhvilluar dhe do të përmirësohet më tej krijimi i një ambjenti miqësor e produktiv pune dhe i një ekuilibri të qëndrueshëm pozitiv në jetën profesionale dhe private të anëtarëve të stafit.

Punësimi

Është një ndër elementët bazë që ndikon drejtpërdrejt në rendimentin dhe cilësinë e punës. Në procesin e punësimit i është kushtuar rëndësi kryesisht aftësive profesionale, aftësive komunikuese dhe cilësive personale që ndihmojnë në punësimin e njerëzve të aftë e të përkushtuar në punë. Prioritet në përzgjedhjen e stafit të AMF-së ka qenë punësimi i të rinjve që janë diplomuar apo kualifikuar me rezultate të larta brenda dhe jashtë vendit. Një orientim i tillë përbën një burim real zhvillimi për punën në këtë institucion.

Në funksion të politikës së punësimit, janë përgatitur dhe hartuar procedurat dhe rregullat e përzgjedhjes së stafit, të cilat i kanë kaluar për miratim Bordit të AMF. Sipas këtyre rregullave, forma kryesore për të afruar burime njerëzore cilësore do të jetë konkurrimi. Gjithashtu do të synohet aplikimi i metodave që do të lejojnë përzgjedhjen e elementeve potencialë, profili i të cilëve përputhet me natyrën e kërkuar të vendit të punës.

Specializimet në punë të punonjësve

Specializimi nëpërmjet punës është një proces i vazhdueshëm, i cili synon transmetimin e njohurive për të siguruar vijimësi të aktivitetit profesional. Sektori i Burimeve Njerëzore e ka përqendruar vëmendjen në trainimet afatshkurtra brenda dhe jashtë vendit, duke u mbështetur edhe në asistencën dhe mbështetjen e donatorëve si Banka Botërore dhe FSVC.

Trainimi i stafit kryesisht ka konsistuar në pjesëmarrjen në konferenca dhe seminare që kanë lidhje me sektorë të ndryshëm të sistemit financiar jobankar, aktiviteti i të cilëve rregullohet dhe mbikëqyret nga AMF. Gjithashtu, Autoriteti synon të nxisë dhe të financojë në një masë të caktuar specializime afatgjata të punonjësve të saj, veçanërisht në drejtime që lejojnë realizimin me sukses të detyrave dhe objektivave kryesore të institucionit.

1.3.5 Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe ligji nr. 9009 datë 13.02.2003 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik", ka kontrolluar dhe verifikuar procedurat e bashkimit të tre institucioneve rregullatore të mëparshme. Nga kontrollet e ushtruara, ka rezultuar se nga pikëpamja ekonomiko-financiare dhe administrativomenaxheriale janë respektuar kërkesat e parashikuara në legjisllacionin në fuqi. Kontrollet përkatëse, të ushtruara për aspekte të veçanta të funksionimit ligjor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, kanë verifikuar respektimin e ligjit në këtë drejtim.

1.3.6 Pasqyrat Financiare

Financimi dhe buxheti i AMF-së për vitin 2006

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në mbështetje të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", neni 26, është institucion i pavarur, që kryesisht financohet nga burimet e veta, por për çdo diferencë ndërmjet burimeve të fondeve dhe shpenzimeve të veprimtarisë, financohet nga buxheti i shtetit deri në çastin kur të ardhurat janë të mjaftueshme për të siguruar funksionimin normal të tij. Pjesa e financimit nga buxheti i shtetit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si pjesë e pavarur e buxhetit të shtetit. Teprica e buxhetit për vitin financiar kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit, brenda 4 muajve pas mbylljes së vitit financiar, me përjashtim të fondeve të destinuara për investime, të cilat janë në proces.

Bazuar në nenin 33 dhe 37 të ligjit nr.9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" si dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr. 8663/1, datë 21.11.2006, u hartua buxheti i AMF-së për vitin 2006 mbështetur në buxhetet e enteve rregullatore paraardhëse, përkatësisht KLV, IIPPS dhe AMS. Bilanci i çeljes së AMF-së është certifikuar nga ekspert i autorizuar i jashtëm.

AMF përgatit pasqyrat financiare dhe e mban kontabilitetin në përputhje me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale dhe njërive që varen prej tyre" si dhe udhëzimet nr. 14, datë 28.12.06 të Ministrit të Financave, "Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore".

Për periudhën e krijimit e funksionimit të AMF (10 tetor deri me 31 dhjetor 2006), burimi dhe përdorimi i fondeve të miratuara paraqitet si më poshtë:

Tabela 1: Burimi i të Ardhurave të AMF-së

Burimi i Fondeve AMF-së (11 Tetor - 31 Dhjetor 2006)	000/Lekë
1. Të trashëg. nga bashkimi i tri institucioneve (10.10.2006)	36,598
1.1. Nga të ardhurat e veta	24,932
1.2. Nga financimi buxhetor	11,666
1.2.1 Për shpenzime funksionimi	10,666
1.2.2 Nga buxheti për investime	1,000
2. Të ardhura realizuar nga AMF (11.10.06 - 31.12.06)	21,475
Totali	58,073



Tabela 2: Përdorimi i Fondeve të AMF-së

Përdorim i Fondeve të AMF-së (11 Tetor - 31 Dhjetor 2006)	000/Lekë
1. Fonde për shpenzime funksionimi	23,027
2. Fonde për investim	31,153
2.1. Për investime të kryera	1,663
2.2. Për investimi në proces	29,490
3. Derdhur në Buxhetin e Shtetit	3,893
Totali	58,073

Në zbatim të neneve 26 dhe 27 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", në të ardhurat e realizuara nga Autoriteti, për periudhën 11.10.2006 deri më 31.12.2006 janë përfshirë të ardhurat nga tregu i sigurimeve, nga tregu i letrave me vlerë, nga tregu i pensioneve, 20% e vlerës së gjobave të arkëtuara, si dhe të ardhura të tjera.

Në shpenzimet e funksionimit sipas planit financiar të miratuar për vitin 2006, shpenzimet për punonjësit në reformë të tre institucioneve të mëparshme zënë 14% të fondit të pagave ose 9% të shpenzimeve të funksionimit.

Investimet janë kryer sipas planit financiar të miratuar, në ndjekje të parashikimeve të bëra në Strategjinë e ngritjes së institucionit. Investimet janë fokusuar për projekte informatizimi, ndërsa investimet për zyra, për shkak të vonesave për vënien në dispozicion të godinës, janë akoma në proces për në vitin në vazhdim.

II. Aktiviteti i AMF-së

2.1 Aktiviteti Rregullues

2.1.1 Ndryshimet Ligjore

Miratimi i ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", solli një ndryshim strukturor të mbikëqyrjes së tregut financiar jobankar për shkak të unifikimit të funksioneve rregullatore të tre institucioneve ekzistuese. Ky ligj përcakton krijimin, përgjegjësitë dhe funksionimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si dhe rregullon fushën e veprimtarisë së këtij institucioni.

Ndryshimi i strukturës së rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregut financiar jobankar, bëri të domosdoshëm edhe ndryshimin e të gjithë kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi për fusha të ndryshme të këtij sektori. Në këtë kontekst, dispozitat e fundit të ligji nr. 9572 parashikojnë ndryshimet që u bëhen ligjeve përkatëse si dhe përcakton strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre, më konkretisht:

- a. në fushën e sigurimeve** – ligji nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime",
- b. në fushën e letrave me vlerë** – ligji nr. 8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë",
- c. në fushën pensioneve private** – ligji nr. 7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve".

Ndryshimet e ligjit të Sigurimeve për Fondin e Garancisë

Në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian (BE), gjatë vitit 2006 janë përgatitur ndryshimet e ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", të cilat reflektojnë një aspekt shumë të rëndësishëm të direktivave të BE-së, lidhur me fondin e garancisë së shoqërive të sigurimit. Këto ndryshime konsistojnë në amendimin e nenit 98 të këtij ligji për ndryshimin e fondit të garancisë në 3 milion Euro, proces që është parashikuar të realizohet në tre faza në të ardhmen.

Direktiva e BE për Fondin e Garancisë së Shoqërive të Sigurimit

Sipas direktivave të BE-se për aktivitetin "jetë" 2002/12 dhe për aktivitetin "jo-jetë" 373 L 0239 rezulton se fondit të garancisë duhet të jetë jo më pak se 3 milion €. Periudha që duhet të përmbushet ky detyrim ligjor është 5 vjet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj direktive.

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm, që ka ardhur si nevojë e zbatimit të ligjit, është ndryshimi i afatit të dorëzimit të raportit vjetor të ekspertit kontabël të autorizuar nga shoqëritë e sigurimeve.



2.1.2 Ndryshimet në Kuadrin Rregullativ

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", u shfuqizuan të gjitha aktet nënligjore në zbatim të ligjeve të fushave përkatëse të cilat binin në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Për shmangien e vakumit të krijuar nga shfuqizimet e mësipërme, lidhur me organizimin e brendshëm administrativ, funksionet e veçanta, përgjegjësitë e departamenteve dhe drejtorive dhe procedurat e komunikimit ndërmjet tyre, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit u hartuan dhe miratuan :

- rregullat e brendshme të AMF-së,
- rregullorja e funksionimit të Bordit të AMF-së.

Rregulloret e miratuara nga AMF gjatë vitit 2006

Në Fushën e Sigurimeve

1. Rregullore " Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit",
2. Rregullore " Mbi përmbajtjen e programit të risigurimit të shoqërive të sigurimit dhe afatet kohore të paraqitjes pranë AMF",
3. Rregullore " Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në AMF",
4. Rregullore " Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit",
5. Rregullore "Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike",
6. Rregullore " Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës",
7. Rregullore "Për disa kritere që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emeruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit"
8. Udhëzim " Për listën e dokumentave të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit",
9. Udhëzim "Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatore",
10. Udhëzim " Për përcaktimin e kriterëve të shoqërive të risigurimit me të cilat shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë mund të lidhin marrëveshje risigurimi".

Në Fushën e Letrave e Vlerë

1. Rregullore "Për kërkesat mbi burimet financiare të personave të licencuar që ushtrojnë veprimtari në letra me vlerë",
2. Rregullore "Për licencimin, kuotat dhe komisionet e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në tregun e letrave me vlerë",
3. Rregullore "Për marrjen e paketës kontrolluese të aksioneve",
4. Rregullore "Për praktikat e paligjshme të tregtimit në letra me vlerë",
5. Rregullore "Për detyrimin për përgatitjen e Prospektit",
6. Rregullore "Për organizimin e provimit të individëve që kërkojnë të pajisen me licencë si përfaqësues tregtari",
7. Rregullore "Për procedurat e monitorimit të tregtimit me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë".

Në Fushën e Pensioneve Private

1. Rregullore "Për procedurat e licencimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare",
2. Rregullore "Për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar të instituteve private të pensioneve suplementare".

Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, AMF ka rishqyrtuar dhe miratuar, të gjitha aktet nënligjore përkatëse të miratuara nga autoritetet rregullatore të mëparshme sipas fushave. Rishqyrtimi i tyre është bërë duke u mbështetur në ndryshimet ligjore, rregullat e reja të miratuara si dhe duke reflektuar nevojat e tregut.

2.1.3 Plani për Ndryshimet Ligjore

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” ndryshoi struktura rregulluese e tregut financiar jobankar. Por ky ndryshim nuk u shoqërua me infrastrukturën e mjaftueshme ligjore për përmbushjen e objektivave dhe përgjegjësisë të ngarkuara me ligj, gjë që krijoi vështirësi në ndërveprimin e aktorëve të këtij tregu. Duke pasur një status më të pavarur, enti rregullator synon të luajë një rol më aktiv në drejtim të fillimit të nismave dhe nxjerrjes së akteve rregullative. Për ndërtimin e arkitekturës institucionale në fushën e sigurimeve do synohet në përcaktimin e qartë të rolit të aktorëve, AMF-së, Ministrit të Financave, Bankës së Shqipërisë, shoqërive të mbikëqyrura dhe shoqatave të këtyre operatorëve. Ky proces do të shoqërohet me propozimin e ndryshimeve ligjore dhe hartimin e një sërë aktesh nënligjore.

Zbatimi i angazhimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, do të vazhdojë të mbetet prioritet në të tre fushat: të sigurimeve, letrave me vlerë dhe instituteve të pensioneve private.

Në fushën e letrave me vlerë, krahas ndryshimeve në ligjin nr. 8080, datë 01.03.1996 “Për letrat me vlerë”, është në proces një projekt bashkëpunimi me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), i cili synon përgatitjen e kuadrit të nevojshëm legjislativ e rregullativ për emetimin e letrave të borxhit (obligacioneve) të shoqërive aksionere dhe njësive të qeverisjes lokale.

Reformë ligjore synohet edhe në fushën e instituteve të pensioneve private ku po përgatitet projektligji “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në përputhje me reformën kombëtare të Qeverisë në fushën e pensioneve.

Për implementimin e metodologjive me bazë vlerësimin e riskut dhe sistemin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS) në fushën e sigurimeve është në proces hartimi i disa akteve nënligjore, të cilat në koherencë me zhvillimet e tregut, do të reflektojnë direktivat më të fundit. Janë në fazën e diskutimit në Autoritet:

- Projekt/Rregullore “Për përcaktimin e procedurave për arritjen e pjesëmarrjes influencuese në shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit;



- Projekt/Rregullore “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për dhënien dhe tërheqjen e autorizimit të aktuarit”;
- Projekt/Rregullore “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për licencimin e ndërmjetësve në sigurime”;
- Projekt/Rregullore “Për përcaktimin e metodologjisë së vlerësimit të dëmeve”;
- Projekt/Rregullore “Për përcaktimin e kriterëve për licencimin e vlerësuesve të dëmeve” duke synuar këtu pavarësi dhe mbikëqyrje më të mirë;
- Projekt/Manual “Për procedurat e inspektimit”;
- Projekt/Rregullore “Për përcaktimin e mënyrës së administrimit të fondit të garancisë”;
- Projekt/Rregullore “Për përcaktimin e procedurave për ndalimin e lëvizjes së lirë të pasurisë së shoqërisë së sigurimit”.

2.2 Aktiviteti Licencimit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, duke respektuar kërkesat e ligjit “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, dhe kërkesat e licencimit në zbatim të ligjeve të fushave (sigurime, letra me vlerë dhe pensione private suplementare) dhe akteve nënligjore, synon sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmerisë dhe barazisë.

Në procesin licencues të subjekteve që operojnë në tregun financiar jobankar, Autoriteti ka si parim bazë përcaktimin e kërkesave të qarta, objektive dhe transparente ndaj publikut.

2.2.1 Aktiviteti Licencues në Sigurime

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Autoriteti i është përgjigjur në kohë kërkesave të paraqitura nga subjektet për licencim, zgjerim aktiviteti, apo ndryshime në kapitalin aksioner dhe stafin drejtues. Kjo ka kërkuar një punë të kujdesshme për shqyrtimin e dokumentacionit përkatës i vënë në dispozicion nga subjektet e interesuara.

▪ Licencimi i ndërmjetësve në sigurime

Veprimtaria e ndërmjetësimit, si veprimtari e negocimit dhe shitjes së kontratave të sigurimit nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, është fokusuar në veprimtarinë e agjentëve. Veprimtaria e brokerimit në sigurime nuk është ende prezent në tregun shiptar të sigurimeve.

Gjatë vitit 2006, në procesin e licencimit të ndërmjetësve në sigurime, u bë i mundur licencimi i subjekteve si vijon:

1) **Shoqëria “Agjensia e Sigurimit të Automjeteve – ASA- sh.a.”** - ASA sh.a. u krijua si shoqëri anonime në përputhje me ligjin “Për shoqëritë tregtare” dhe u licencua nga Autoriteti rregullator përkatës me licencën nr.4, datë 12.04.2006 për të operuar si shoqëri agjentësh në shitjen e produkteve të sigurimit të jo-jetës. E krijuar nga 7 aksionerë, ku secili zotëron paketa të barabarta aksionesh, ASA sh.a ngriti sistemin online, i cili mundëson shitjen online në sistem kompjuterik të produkteve të sigurimit në përputhje me VKM nr. 192, datë 25.03.2005 “Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre”. Ky sistem online për herë të parë mundësoi një shërbim të shpejtë dhe korrekt ndaj kompanive, por gjithashtu edhe ndaj klientëve.

Në vitin 2006, ASA operoi si rrjet shitje për 7 kompani sigurimi duke aplikuar tarifa fikse sipas kontratave me këto kompani. Gjatë kësaj periudhe, pati rreth 50 pika shitje që mbulonin të gjithë territorin e Shqipërisë, të lidhura on-line me ASA qendër dhe shoqëritë, me të cilat kishte kontraktuar për shitjen e produktit të sigurimit të detyrueshëm motorrik TPL e brendshme.

2) **Shoqëria “Posta Shqiptare sha.”** - U licencua për të operuar si agjent në shitjen e produkteve të sigurimit të jo-jetës me licencë nr. 2, datë 10.3.2006. Gjithashtu, shoqëria “Posta Shqiptare sh.a.” plotësoi të gjitha kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi për personat, të cilët do të kryenin veprimtarinë e agjentit në sportelet e këtij institucioni.

3) **16 agjentë fizikë të shoqërisë Insig sh.a.** – U licencuan për të vepruar si agjentë në sigurime të jo-jetës për llogari të shoqërisë “Insig sh.a.”, me afat licencë 3 vjet me të drejtë ri-licencimi. Vlefshmëria e licencës ishte e lidhur me nënshkrimin e kontratës me shoqërinë e sigurimit dhe me instalimin e programit on-line të shitjes.

■ **Miratime në lidhje me shoqërite e sigurimit**

1) Me Vendimin nr. 5, datë 03.02.2006, Autoriteti miratoi ndryshimin e emrit të shoqërisë së sigurimit nga “Dukagjini AI sh.a” në “Eurosig sh.a”, pas miratimit të ndryshimeve në aksionerët e shoqërisë dhe stafin drejtues. Ndryshimi i emrit u bë si rezultat i ndryshimit të strategjisë së shoqërisë në aspektin menaxhues dhe operacional në tregun e sigurimeve dhe reflektimit të një vizioni të ri.

2) Me Vendimin nr. 6, datë 03.02.2006, Autoriteti miratoi ushtrimin e veprimtarisë së risigurimit për shoqërinë e sigurimit “Sigal sh.a.”. Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004



“Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” neni 20 pika 3/c, parashikon rastin kur shoqëria mund të licencohet nga Autoriteti edhe si shoqëri sigurimi edhe si shoqëri risigurimi.

- 3) Në dhjetor 2006, AMF miratoi hapjen e zyrës së përfaqësimit në Tiranë për shoqërinë e sigurimeve “Intersalonika” General Insurance S.A. me qendër në Selanik të Greqisë. Qëllimi i hapjes së kësaj zyre është studimi i tregut dhe krijimi i kushteve përgatitore dokumentare për të filluar në të ardhmen aktivitetin si shoqëri sigurimesh në Shqipëri. Hapja e zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja është një risi për tregun vendas të sigurimeve.

Tabela 3: Lista e Shoqërive të Licencuara në Fushën e Sigurimeve

Nr.	Shoqëritë e licencuara	Lloji i veprimtarisë	Pronësia	Koha e marrjes së licencës
1.	Insig sh.a	Sigurimi i jetës + jojetës	Qeveria Shqiptare + BERZH + IFC	08.06.2000
2.	Sigma sh.a	Sigurimi i jojetës	Kapital Privat Vendas	03.02.1999
3.	Sigal sh.a	Sigurimi i jojetës	Kapital Privat Vendas + Fondi Shqiptaro-Amerikan	23.06.1999
4.	Atlantik sh.a	Sigurimi i jojetës	Kapital Privat Vendas	01.06.2001
5.	Intersig sh.a	Sigurimi i jojetës	Kapital Privat Vendas	13.09.2001
6.	Interalbanian sh.a	Sigurimi i jojetës	Kapital Privat Vendas	10.09.2004
7.	Albsig sh.a	Sigurimi i jojetës	Kapital Privat Vendas	10.09.2004
8.	Eurosig sh.a	Sigurimi i jojetës	Kapital Privat Vendas	10.09.2004
9.	Sigal Life sh.a	Sigurimi i jetës	Kapital Privat Vendas + Fondi Shqiptaro-Amerikan	10.09.2004
10.	Sicred sh.a	Sigurimi i jetës	Kapital Privat Vendas	10.09.2004

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2006, kompani të ndryshme financiare të huaja, kryesisht me aktivitet në fushën e sigurimeve paraqitën interesin e tyre për sektorin shqiptar të sigurimeve duke kërkuar pjesmarrje pronësie në shoqëritë shqiptare të sigurimit. Kështu, priten të ndodhin ndryshime në aksionerët e shoqërisë së sigurimit “Interalbanian”, shoqërisë “Albsig”, shoqërisë “Sigal”, apo të ndonjë shoqërie tjetër.

2.2.2 Aktiviteti Licencues në Tregun e Letrave me Vlerë

Gjatë vitit 2006, në fushën e letrave me vlerë, Autoriteti ka synuar zgjerimin e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë (Bono Thesari) duke zgjeruar numrin e subjekteve të licencuara që operojnë në këtë treg.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - rregullator i tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është tregu i organizuar në sportelet fizike apo virtuale të bankave dhe subjekteve të tjera të licencuara, për kryerjen e transaksioneve me investitorët të cilët mund të jenë, persona fizikë ose juridikë, rezidentë dhe jorezidentë.

Ndërmarrja e veprimtarisë së tregtimit në tregun me pakicë dhe e mbajtjes së regjistrimit analitik bëhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Mbajtja e regjistrimit analitik përbën kusht për licencimin e tregtarit të letrave me vlerë të Qeverisë që do operojë në tregun me pakicë.

Regjistri siguron mbajtjen e të dhënave në mënyrë analitike për investitorët mbi pronësinë e letrave me vlerë të Qeverisë, transaksionet e kryera në lidhje me këto letra me vlerë apo të dhëna në lidhje me vendosjen e tyre si garanci.

Në fund të vitit 2006, tregu i letrave me vlerë numëroi:

- 10 shoqëri të licencuara për të vepruar si tregtar në letrat me vlerë, nga të cilat 5 banka me të drejtë tregtimi edhe në tregun me pakicë të bonove të thesarit.
- 14 përfaqësues të licencuar të tregtarëve të letrave me vlerë
- 5 regjistruar të licencuar të letrave me vlerë të Qeverisë
- Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, dhe
- Bursën e Tiranës.

Në fillim të vitit 2006, Banka ALFA filloi aktivitetin si tregtar letrash me vlerë dhe njëkohësisht si regjistruar i bonove të thesarit. Listës së bankave, regjistruar të letrave me vlerë të Qeverisë, iu shtua edhe Banka Credins, e cila u licencua më 08.05.2006, duke e çuar në 5 numrin e subjekteve të licencuara për këtë aktivitet.

Në maj 2006, Autoriteti përkatës licencoi Bankën Italo-Shqiptare si tregtar letrash me vlerë. Sipas kërkesës së subjektit, licenca u miratua për një afat 1 vit. Në dhjetor 2006, AMF rilicencoi dy përfaqësuesit e tregtarit të letrave me vlerë "Banka Amerikane e Shqipërisë", të cilët përfaqësojnë subjektin në veprimet e tregtimit në Bursë dhe në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

Ekzistenca dhe zhvillimi i tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë ka ngjallur interes tek shumë subjekte brenda dhe jashtë vendit, të cilët kanë shprehur interes për t'u bërë pjesmarrës të këtij tregu.



Tabela 4: Shoqëritë me licencë tregtari për vitin 2006

Nr.	Emërtimi i shoqërive	Nr.përfaqësuesve	Afati i licencës
1.	Banka Tirana sh.a.	1	Pa afat
2.	Triumf Grup sh.a.	1	Pa afat
3.	Banka Credins sh.a.	1	Pa afat
4.	Ballkan Group-01 sh.a.	2	Pa afat
5.	Raiffesen Bank sh.a.	1	Pa afat
6.	Banka Kombëtare Tregtare sh.a	2	Pa afat
7.	Banka Popullore sh.a.	1	Pa afat
8.	Banka Italo-Shqiptare sh.a.	1	Nje vit
9.	Banka Amerikane e Shqipërise sh.a.	2	Pa afat
10.	Banka Alfa	2	Pa afat

Mbështetur në Ligjin nr. 8080, datë 01.03 1996 “Për Letrat me Vlerë”, në Rregulloren “Mbi licencimin e regjistruarve të letrave me vlerë” dhe Rregulloren “Për tregtimin me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së RSH”, janë licencuar në cilësinë e regjistruarve, subjektet e mëposhtme.

Tabela 5: Shoqëritë me licencë regjistruarve të letrave të Qeverisë për vitin 2006

Nr.	Subjekti i licencuar	Lloji i licencës	Afati i licencës
1.	Raiffesen Bank sh.a.	Regjistruar i letrave me vlerë të Qeverisë	Pa afat
2.	Banka Amerikane e Shqipërise sh.a.	Regjistruar i letrave me vlerë të Qeverisë	Pa afat
3.	Banka Kombetare Tregtare sh.a	Regjistruar i letrave me vlerë të Qeverisë	Pa afat
4.	Banka Alfa sh.a.	Regjistruar për Bono Thesari	Pa afat
5.	Banka Credins sh.a.	Regjistruar për Bono Thesari	Pa afat

2.2.3 Subjektet që Operojnë në Tregun e Pensioneve Private Suplementare

Në mbështetje të ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve” dhe akteve nënligjore, janë licencuar 3 shoqëri që ushtrojnë aktivitetin në tregun privat të pensioneve suplementare. Ligji përcakton kërkesat për krijimin e Instituteve të Pensioneve, ku ndër të tjera përcakton edhe rastin e krijimit të Institutit të pensioneve nga më shumë se një punëdhënës. Sipas këtij ligji, të paktën njëri prej këtyre

punëdhënësve duhet të ketë të punësuar më shumë se 100 persona dhe të gjithë së bashku të paktën 500 persona. Institutet e Pensioneve Private Suplementare të krijuara dhe që operojnë në tregun shqiptar i përgjigjen këtij rasti ligjor.

- Shoqëria “GARANTSIG Institut Privat Pensionesh”, u licencua nga Autoriteti përkatës me Vendimin nr.1, datë 01.07.2005,
- Shoqëria “IAPPSSH – Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë” u licencua nga Autoriteti përkatës me Vendimin nr.2, datë 01.07.2005,
- Shoqëria “CAPITAL Institut Privat Pensionesh”, u licencua nga Autoriteti përkatës me Vendimin nr.3, datë 12.12.2005.

2.2.4 Qeverisja e Shoqërive Aksionere

AMF, në përpjekjet për rritjen e rolit të tij në përmirësimin e klimës së qeverisjes së shoqërive aksionere (corporate governance) ka synuar në promovimin dhe implementimin e Dokumentit Final (White paper) të OECD “Mbi Parimet e Qeverisjes së Shoqërive Aksionere në Europën Juglindore”, duke identifikuar njëkohësisht fushat me të rëndësishme, në të cilat duhet ndërmarrë reforma për një mirëqeverisje të shoqërive aksionere.

Në rritjen e rolit të tij mbi qeverisjen e shoqërive aksionere, Autoriteti ka synuar në përcaktimin e kriterëve të qarta për të zgjedhurit në Këshillat Mbikëqyrës të subjekteve të licencuara, në postet drejtuese apo komitetin e kontrollit, duke insistuar në rritjen e integritetit, profesionalizmit, eksperiencës dhe kualifikimit.

AMF anëtar i Forimit Shqiptar të Qeverisjes së Shoqërive Aksionere

Komisioni i Letrave me Vlerë (sot AMF) në cilësinë e bashkë-themeluesit, nënshkroi në datën 14 Qershor 2005 rezolutën për krijimin e Forimit Shqiptar të Qeverisjes së Shoqërive Aksionere.

Forumi u krijua si një organizim në formën e një rrjeti institucionesh dhe organizatave me interesa, ndikim dhe vullnet të përbashkët në drejtim të përmirësimit të nevojshëm të praktikave të qeverisjes së shoqërive aksionere në Shqipëri. Forumi synon të japë kontributin e tij në zbatimin e parimeve dhe standardeve bashkëkohore për Qeverisjen e Shoqërive Aksionere në Shqipëri.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar i Forimit Shqiptar të Qeverisjes së Shoqërive Aksionere. Gjate vitit 2006, vazhduan takimet dhe aktivitetet e Forimit, ku vlen të theksohen:

- 1) Analiza e konkluzioneve të vëzhgimit të realizuar nga OECD mbi gjendjen e zbatimit të Rekomandimeve të White Paper,
- 2) Aktivizimi i Forimit në punën për popullarizimin e parimeve dhe standardeve bashkëkohore të fushës,
- 3) Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Forimit Shqiptar për Qeverisjen e Shoqërive Aksionere dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC), me synim arritjen e objektivave afatshkurtër dhe afatgjatë për përmirësimin e nivelit të përgjithshëm të qeverisjes së shoqërive aksionere në Shqipëri.



2.3 Aktiviteti Mbikëqyrës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvillon funksionet e veta të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare përmes monitorimit të tregjeve në tërësi dhe të performancës së aktorëve të tregut në veçanti. Gjithnjë e më tepër mbikëqyrja është duke u fokusuar në identifikimin, matjen, parandalimin dhe eliminimin e shkallës së rreziqeve që kërcënojnë performancën e tregut dhe si rrjedhim interesat e konsumatorëve. Mbikëqyrja me bazë riskun, si model i ri i mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare, përbën një shkëputje nga metodat tradicionale të vëzhgimit statik, apo ndërhyrjeve vetëm në rast të shkeljeve të kufizimeve ligjore dhe shkon drejt një sistemi bashkëkohor të analizës, ku ndërhyrjet rregullative zënë fill që me marrjen e sinjaleve të hershme që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg.

Mbikëqyrja me bazë riskun

Tradicionalisht, metoda e mbikëqyrjes ka qenë analiza e operacioneve të shoqërisë, për t'u siguruar që shoqëria ka respektuar legjislacionin dhe rregulloret në fuqi si dhe të sigurojë që të dhënat financiare janë përgatitur sipas metodave të duhura të raportimit dhe pasqyrojnë saktë situatën financiare reale të shoqërisë.

Mbikëqyrja me bazë riskun e çon këtë metodë disa hapa përpara, kështu që procesi i mbikëqyrjes identifikon dhe fokusohet në fushat me përmbajtje më të lartë risku të shoqërisë, ato të cilat dëmtojnë mbarëvajtjen financiare të shoqërisë. Mbikëqyrja me bazë riskun nuk auditon rezultatet financiare të shoqërisë së sigurimit. Fokusi i saj janë identifikimi i risqeve që ndikojnë biznesin si dhe proceset menaxheriale për të parandaluar dhe minimizuar këto risqe.

Mbikëqyrja me bazë riskun merr në konsideratë çdo risk që shoqëria përballet dhe me anë të një procesi të strukturuar identifikon risqet që janë thelbësore për mbarëvajtjen financiare të shoqërisë. Mbikëqyrja kontrollon se si këto risqe menaxhohen dhe fokusohet në ekspozimin e shoqërisë ndaj risqeve më kritike. Në këtë mënyrë fokusi mbetet tek risqet, tek procesi menaxherial, tek ndryshueshmëria e rezultateve dhe impakti i tyre në mbarëvajtjen e shoqërisë.

Me kalimin e kohës, zhvillimi dhe stabilizimi më i forte i tregut do të sjellë sofistikim të këtyre metodave të mbikëqyrjes me bazë riskun

AMF e kryen funksionin e saj të mbikëqyrjes së tregjeve përmes a) analizimit të dokumentave (mbikëqyrja dokumentare "off-site") të vëna në dispozicion nga subjektet e mbikëqyrura, raportimeve të rregullta periodike, apo atyre të veçanta (ad-hoc) dhe b) ndërrmarjes së inspektimeve në vend tek subjektet e mbikëqyrura (mbikëqyrja në vend "on-site") me qëllim verifikimin e të dhënave. Mbikëqyrja në vend dhe analiza mund të përfshijnë një tematike të gjerë, ose mund të fokusohen në çështje të veçanta.

Treguesit për Monitorimin Off-Site në Shqipëri

AMF në bashkëpunim me Bankën Botërore organizoi një konferencë për “Analizën e treguesve financiarë për Sigurimet” në datat 5-6 Dhjetor në Hotel Tirana. Pjesëmarrësit patën mundësinë të ndiqnin një leksion 1 ditor lidhur me treguesit financiarë Off-Site që përdoren për të shqyrtuar gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit të jo-jetës. Objektivi i kësaj konference ishte që të gjithë pjesëmarrësit, përfaqësuesit e shoqërive, auditorë të jashtëm, dhe stafi i AMF të arrijnë të kenë njohuri bazë të njëjta për rëndësinë e treguesve financiarë, sesi disa prej këtyre treguesve llogariten, dhe si t'i interpretojnë rezultatet në vlerësimin e aktiviteteve dhe gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit. Pas leksionit, nga AMF u organizua një test për të gjithë pjesëmarrësit në lidhje me njohuritë mbi treguesit financiarë Off-Site. Të gjithë pjesëmarrësit që ishin të suksesshëm në test, morën një diplomë për nivelin bazë të njohurive për treguesit financiarë. Ky leksion u ndoq nga menaxherë të shoqërive të sigurimit, drejtues sektorëve të ndryshëm të AMF dhe punonjës nga dy shoqëri audituese.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2006 i ka dhënë përparësi rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, nisur nga pesha e këtij sektori në tregun financiar, madhësia dhe dinamika e tij. Ndërkohë, vëmendja nuk është shpërndarë nga monitorimi i kujdesshëm dhe mbështetja për një zhvillim të shëndetshëm të tregjeve të letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare.

Mbikëqyrja në Vend (On-Site) - nga Standardet e IAIS

Mbikëqyrja në vend është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes, i cili është i lidhur ngushtë me procesin e monitorimit në vazhdimësi. Nga njëra anë, inspektimi jep një informacion që është shtesë e informacionit të analizave financiare dhe statistikore të dërguara nga subjektet. Nga ana tjetër, inspektimi në vend kërkon mbështetje të informacionit të tregut dhe të statistikave që rrjedhin nga analizat e pasqyrave financiare (të ardhura dhe shpenzime, bilanci vjetor, etj). Mbikëqyrja në vend lejon mbikëqyrësin të marrë informacion dhe të identifikojë problemet që nuk mund të identifikohen nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, në veçanti si më poshtë:

- a. në rastin e shoqërive me probleme me aktivet, parregullsi kontabile apo dobësi në menaxhim, mbikëqyrja në vend lejon mbikëqyrësin të identifikojë problemet që shoqëria me dashje mund të mos t'i ketë marrë në konsideratë dhe disa herë madje duke i fshehur;
- b. i ofron mbikëqyrësve mundësinë për të krijuar një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me drejtuesit e shoqërive, e cila është shumë e rëndësishme për t'u njohur më nga afër me efektivitetin e punës së drejtuesve.
- c. u lejon mbikëqyrësve të vlerësojnë si procesin e marrjes së vendimeve nga ana e drejtuesve të shoqërisë, ashtu edhe efektshmërinë e kontrollit të brendshëm;
- d. mund të shërbejë për të këshilluar shoqëritë për të shmangur ato lloj aktivitetesh, të cilat mund të jenë joligjore dhe të papërshtatshme;
- e. i jep mbikëqyrësve mundësinë për të analizuar impaktin e rregullorëve specifikë dhe shumë shpesh mbledhjen e informacionit për të bërë krahasime me standardet.



Raportimi – nga Standardet e IAIS për Raportimin

a. Autoriteti Mbikëqyrës:

- vendos kriteret për paraqitjen në Autoritet të informacioneve financiare në mënyrë sistematike, të raporteve aktuariale dhe informacione të tjera nga të gjitha shoqëritë e sigurimeve të licencuara në jurisdiksion,
- përkufizon qëllimin dhe shpeshësinë e këtyre raporteve dhe informacioneve duke përfshirë edhe kritere që percaktojnë nëse këto raporte dhe informacione duhet të auditohen,
- kërkon si minimum që çdo vit të ketë një raport auditimi,
- kërkon informacion më të shpeshtë dhe më të detajuar sa herë që kjo të jetë e nevojshme,

b. Autoriteti Mbikëqyrës:


- u kërkon shoqërive të sigurimit të paraqesin informacion rreth gjendjes së tyre financiare në baza individuale dhe grupi. Mund të kërkojë dhe të marrë informacion financiar për çdo filial të shoqërisë së mbikëqyrur,
- kërkon që shoqëritë e sigurimit të raportojnë çdo ekspozim jashtë bilancit financiar,
- kërkon që shoqëritë e sigurimit të raportojnë për funksione të deleguara si “outsourced” shoqërive të tjera,
- kërkon që niveli i duhur i menaxherëve të shoqërisë së sigurimit të raportojë për afatin kohor dhe saktësinë e këtyre,
- kërkon që informacioni i pasaktë të korrigojë dhe ka autoritet të vendosë sanksione për raportim me qëllime jo të ndershme.

2.3.1 Tregu i Sigurimeve


Struktura dhe Vëllimi i Tregut

Gjatë vitit 2006 në treg vazhduan të ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhjetë shoqëri të sigurimeve, nga të cilat shtatë në sigurimet e jo-jetës, dy në sigurimet e jetës dhe një në sigurimet e jo-jetës dhe jetës së bashku. Në 2006 numri i policëmbajtësve arriti në 507,375 duke shënuar një rritje prej rreth 9,5% në krahasim me vitin 2005. Rritja e numrit të policëmbajtësve në 2006 u shoqërua me rritjen e vëllimit të të ardhurave nga primet. Primet e shkruara bruto të sigurimeve arritën në rreth 4,5 miliardë lekë, shifër kjo 11,95% më e lartë se ajo e vitit 2005. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e jo-jetës që sollën rreth 93% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e jetës me rreth 7%.

Struktura e primeve të sigurimeve 2006




Ecunia mujore e primeve të shkruara bruto të sigurimeve në 2006



Sigurimet e Detyrueshme

Gjatë vitit 2006 sigurimet e detyrueshme vazhduan të dominojnë në tregun Shqiptar, duke sjellë rreth 66% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të sigurimeve. Për vetë specifikat e zhvillimit, tregu i sigurimeve të detyrueshme ka mbetur i paliberalizuar në drejtim të çmimeve. Për TPL-në e brendshme dhe policën kufitare çmimet minimale dhe maksimale përcaktohen një herë në vit me udhëzim të Ministrisë së Financave, pas rekomandimeve të kryera nga specialistët e tregut. Për produktin e kartonit jeshil ende zbatohen çmime fikse të përcaktuara vite më parë.

Primet mujore të sigurimeve të detyrueshme (në mijë lekë)






- Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit të TPL-së së brendshme në 2006 ishin rreth 1,57 miliardë lekë. Rritja e të ardhurave me 14,46% krahasuar me vitin 2005 u lidh kryesisht me rritjen që prej muajit Maj 2006 të nivelit minimum të çmimeve të shitjes së produktit, ndërsa numri i kontratave mbeti pothuajse i njëjtë. Gjatë vitit 2006 u ul tendenca e shoqërive të sigurimit për të shitur policat e sigurimit TPL me çmime poshtë niveleve të lejuara. Kjo erdhi si rezultat: a) i zbatimit të VKM-së për lëshimin dhe raportimin në kohë reale (on-line) të policave të sigurimit dhe b) i marrëveshjeve të operatorëve në lidhje me mënyrat e funksionimit të rrjeteve të tyre të shitjes. Këto lëvizje u shoqëruan me ndryshimet përkatëse në pjesët e tregut të zotëruara nga operatorët.
- Rritja e të ardhurave të kartonit jeshil ishte në një linjë me rritjen e numrit të kontratave. Në vitin 2006, primet e shkruara bruto arritën në rreth 648 milionë lekë, ose 11,72% më shumë se në vitin 2005. Për vetë veçoritë e produktit, kryesisht kohëzgjatjen dhe natyrën e pakufizuar të përgjegjësive, risigurimi cilësor mbetet domosdoshmëri. Në vitin 2006, Autoriteti zvogëloi nga pesë në katër numrin e operatorëve të licencuar për të shitur policën e kartonit jeshil. Shoqëria Intersig sh.a. nuk mundi të gjente risigurim të përshtatshëm për të përmbushur kriterin e mbajtjes maksimale për rrezik të përcaktuar në ligj. Aktualisht shoqëritë e licencuara që lëshojnë polica të kartonit jeshil janë: Insig sh.a., Sigal sh.a., Sigma sh.a. dhe Atlantik sh.a.
- Sigurimi kufitar shënoi rritjen më të madhe në grupin e sigurimeve të detyrueshme me rreth 25% në krahasim me vitin 2005. Në rritje ndikoi shtimi i numrit të policave, rritja e çmimeve dhe funksionimi i një rrjeti të përbashkët të shitjeve për të gjithë operatorët në treg. Në 2006, primet e shkruara nga policat kufitare arritën në rreth 528 milionë lekë.

Sigurimet Vullnetare

Në 2006, numri i kontratave vullnetare të sigurimit u rrit me rreth 17%, ndërsa vëllimi i primeve me 6,25% krahasuar me 2005, duke arritur shifrën 1,53 miliardë lekë. Të ardhurat nga produktet vullnetare të sigurimit të jo-jetës mbetën në nivelin e vitit 2005, ndërsa në produktet e sigurimit të jetës pati një rritje të konsiderueshme prej 29% krahasuar me një vit më parë. Kjo shifër reflekton një tendencë në rritje të ndërgjegjësimit të konsumatorit për nevojën e transferimit të rrezikut në shoqëritë sigurimit. Tregu i produkteve vullnetare të sigurimit mbetet ende në nivele të ulëta, duke patur parasysh këtu potencialet e mëdha të pashfrytëzuara që ka vendi. Zhvillimi i tij është i lidhur ngushtë me nivelin ekonomik, por edhe me shkallën e edukimit dhe besimin e konsumatorëve ndaj operatorëve të tregut.

- Në sigurimet e pronës me të ardhura rreth 785 milionë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 49% të të ardhurave të sigurimeve të pronës, të pasuara nga sigurimet e garancisë me 17%. Pati një rritje të ndjeshme të sigurimit nga zjarri në 6-mujorin e dytë të vitit 2006, të lidhur me kërkesën e bankave ndaj klientëve të tyre për sigurimin e objekteve gjatë kohëzgjatjes së kredisë. Rritja e

Primet mujore të sigurimeve të detyrueshme (në mijë lekë)



numrit të kontratave dhe primeve nga sigurimet e garancisë, nisur edhe nga specifikat që ato paraqesin, është shoqëruar me një monitorim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme nga AMF në drejtim të përcaktimit të shkallës së rrezikut të marrë përsipër nga operatorët, kryesisht nëpërmjet fenomenit të transferimit të rrezikut nga bankat apo subjektet e tjera tek shoqëritë e sigurimit.


- Në grupin e sigurimeve të pronës është me interes të përmendet që sigurimet inxhinierike ishin në nivel të ulët, megjithë zhvillimin e tregut të ndërtimit në Shqipëri.
- Pavarësisht rëndësisë që kanë në stadin aktual të zhvillimit të vendit, edhe sigurimet e përgjegjësisë mbetën në nivele të ulëta. Veprimtaria e operatorëve në tregun e karburanteve, ndërtimeve, hotelerisë & turizmit, etj. në më të shumtën e rasteve është e pasiguruar ndaj dëmtimeve që mund të shkaktojë ndaj të tretëve. E pambuluar në sigurim rezulton të mbetet edhe përgjegjësia profesionale në fusha të ndryshme.
- Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve personale dhe shëndetit në 2006 arritën në rreth 177 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej 21% në krahasim me 2005. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 82% të të ardhurave të këtij grupi. Rritja e madhe e të ardhurave në sigurimin e shëndetit në udhëtim lidhet më numrin në rritje të vazhdueshme të personave që udhëtojnë jashtë vendit.
- Tregu i sigurimeve të jetës në vitin 2006 u nda nga tre operatorë: Insig sh.a., Sigal sh.a. dhe Sicred sh.a.. Vëllimi i primeve të sigurimit të jetës ishte rreth 308 milionë lekë.

Dëmet

- Totali i dëmeve të paguara nga shoqëritë e sigurimeve në vitin 2006 ishte rreth 1,28 miliardë lekë, ose 7.5% më shumë se në vitin 2005. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur




Pagesat e dëmeve nga shoqëritë e jo-jetës në 2006 (në mijë lekë)



më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve të detyrueshme me 928 milionë lekë, apo 72% të totalit.

- Provigjonet për dëmet përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të përgjegjësive në bilancet e të gjitha shoqërive të sigurimit. Ato janë të lidhura me masën e përgjegjësive të shoqërive për dëmet e ndodhura, por të papaguara ende prej tyre.
- Vlen për t'u theksuar që raporti dëme/prime për tregun në masën 35% është i ulët krahasuar me nivelin e vendeve të tjera të rajonit. Për më tepër, ky raport është shumë i ulët duke marrë parasysh që sigurimet e detyrueshme zënë vendin kryesor në strukturën e sigurimeve. Kjo tregon që dëmshpërblimet ndaj klientëve nuk vlerësohen në masën e duhur prej shoqërive të sigurimit.

Pagesat e dëmeve nga shoqëritë e jo-jetës në 2006 (në mijë lekë)



- Në përmbushje të misionit themelor të mbrojtjes së interesave të konsumatorit, AMF po i kushton një vëmendje të veçantë procesit të trajtimit, vlerësimit dhe pagesave të dëmeve të sigurimeve nga ana e operatorëve të tregut. Të gjitha shoqëritë e siguri-


meve iu nënshtroan inspektimit në vend të ushtruar nga AMF në periudhën Tetor – Dhjetor 2006 me tematikë trajtimin dhe pagesat e dëmeve prej tyre. Pas konkluzioneve të analizës së bazuar në gjetjet e inspektimit në vend, Autoriteti ndërmori masa korrektuese dhe penalizuese për shoqëri të ndryshme. Ndërkohë, AMF në bashkëpunim me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë dhe përfaqësues të interesit të konsumatorëve ka nisur një projekt për standardizimin e procedurave të raportimit, trajtimit dhe pagesave të dëmeve, parë ngushtë me rishikimin dhe përmirësimin e termave dhe kushteve të kontratave të sigurimit. Prioritet përbën ngritja e një njësie të grumbullimit të të dhënave historike për dëmet që do t'i shërbejë jo vetëm mbikëqyrjes, por edhe vetë shoqërive në drejtim të zhvillimit të sistemeve të diferencuara të tarifimit të bazuara në eksperiencën e dëmeve.

Risigurimet

- Niveli i primeve të kaluara në risigurim për vitin 2006 ishte 486 milionë lekë, rreth 11% e totalit të primeve të shkruara bruto. Shoqëritë kanë kryer risigurimin e portofoleve, apo kontratave të veçanta të sigurimit në funksion të rritjes së kapacitetit të tyre dhe zbutjes së efekteve financiare prej dëmeve të mëdha. Shoqëritë kanë lidhur marrëveshje të risigurimit për transferimin e përgjegjësisë të kartonit jeshil, pronës, TPL-së së brendshme dhe jetës së debitorit. Kontratat fakultative të risigurimit kanë mbështetur kontratat origjinale të sigurimit të shoqërive kryesisht në sigurimet inxhinierike, sigurimet e marinës dhe aviacionit dhe sigurimet e përgjegjësisë. AMF ka monitoruar marrëveshjet dhe kontratat fakultative të risigurimit në përputhje me kërkesat ligjore të mbajtjes maksimale për rrezik dhe kriterëve të lidhura me cilësinë e risiguruesve. Është për t'u përmendur rritja e cilësisë së risiguruesve pjesëmarrës në rinovimet e marrëveshjeve të risigurimit të shoqërive të kryera në periudhën Tetor – Dhjetor 2006.
- Një opsion në rritjen e efektivitetit të risigurimeve është krijimi i një skeme, apo faciliteti të përbashkët për risigurim, i cili do të shërbejë si një levë për arritjen e marrëveshjeve cilësore të risigurimit duke synuar risigurues cilësorë. Ekzistojnë eksperiencat të ndryshme në botë, si p.sh. risigurimi në grup (pool reinsurance), apo ekzistenca e shoqërive vendase të risigurimit. Një ide e tillë është përkrahur edhe nga Banka Botërore dhe mund të vihet në zbatim në një të ardhme të afërt, pas analizimit të alternativave të mundshme për mënyrat e administrimit.

Renditja e Shoqërive në vitin 2006

- Në vitin 2006, shoqëria Sigal vazhdoi të udhëheqë tregun e sigurimeve të jo-jetës me 27,34% të totalit të primeve të sigurimit. Ndërkohë, Insig-u përmirësoi pozicionin e tij duke kaluar në vendin e dytë me 18,64% të primeve, duke lënë në vendin e tretë shoqërinë Sigma me 18,40%. Shoqëritë e tjera vijojnë përkatësisht: Atlantik – 11,39%; Intersig – 8,00%; Interalbani – 7,05%; Albsig – 5,95%; dhe Eurosig – 3,23%.



- Në sigurimet e jetës, shoqëria Insig ruajti pozicionin e saj me 42,39%, e ndjekur nga Sigal-Life me 35,14% dhe Sicred me 22,47% të totalit të primeve.
- Shoqëria Sigma u rendit e para me pagesën e 32,12% të totalit të dëmeve të paguara nga shoqëritë. Shoqëritë e tjera vijojnë përkatësisht: Sigal – 25,28%; Insig – 17,63%; Intersig – 9,40%; Atlantik – 8,21%; Interalbani – 3,61%; Albsig – 2,48% dhe Eurosigsig – 1,28%.

Analiza Financiare e Sektorit të Sigurimeve

Në periudhën nëntor – dhjetor 2006 AMF, me mbështetjen teknike të Bankës Botërore kreu një diagnostikim të tregut të sigurimeve, duke shqyrtuar eksperiencën dhe gjendjen aktuale të tij. Analiza shërbeu për identifikimin e problemeve, fenomeneve të tregut, tendencave dhe skenarëve të mundshëm në të ardhmen.

Diagnostikimi i gjendjes financiare të sektorit të sigurimeve u përqëndrua në vlerësimin e shoqërive nëpërmjet normave të sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve) të përshtatura për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës në Shqipëri. Ky diagnostikim përfshiu vlerësimin e administrimit të dëmeve, të praktikave të mbajtjes së rrezikut dhe të aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit, si hapi i parë drejt një strategjie të plotë të AMF-së me qëllim hartimin e konkluzioneve fillestare dhe vijimin më tej të veprimtarisë mbikëqyrëse.

Raportet financiare të modelit të mësipërm vlerësohen shumë të rëndësishme në ndërtimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm (early warning), si element themelor i modelit modern të mbikëqyrjes me bazë riskun. Paralajmërimi i hershëm synon evidentimin në kohën e duhur të problemeve që mund të çënojnë interesat e konsumatorëve dhe stabilitete-


tin e tregut, si edhe monitorimin në vazhdimësi dhe ndërhyrjen, apo marrjen e masave përkatëse nga AMF.


Rëndësia e raporteve (indikatorëve financiarë IRIS) – Diapazonet e vlerave të raporteve.

Raporti	Maksimum	Minimum
Norma e Rritjes së Primit	+ 40	- 40
Mbajtja Neto	80	40
Raporti Shpenzime/Prime	50	25
Raporti Dëme/Prime	80	50
Raporti i Kombinuar	105	85
Të Ardhura nga Investimet	8	4
Të Ardhura të Tjera	1	N/A
Raporti Operativ	101	80
Raporti i Fitimit	20	- 1
Kapitali ndaj të Primeve Bruto	50	20
Kapitali ndaj Provigj. Teknike	30	10
Raporti i Aftësisë Paguese	300	150

- Pjesa më e madhe e shoqërive të jo-jetës kanë një normë të rritjes brenda kufijve të përcaktuar.
- Raporti i mbajtjes neto është relativisht i lartë në kuadër tregu. Normat e përcaktuara ndërkombëtare rekomandojnë vlera midis 40 – 80%, ndërkohë që në tregun shqiptar raporti është në masën 87.8 %. Edhe pse në dukje kjo do të komentohej me cedim të ulët në risigurim, shuma të larta në vlerë absolute transferohen jashtë territorit. Norma e lartë e mbajtjes është e lidhur edhe me strukturën e sigurimeve në Shqipëri. Dominimi i sigurimit të TPL-së së brendshme dhe sigurimit kufitar, ndikon padyshim në normën e lartë të mbajtjes nga shoqëritë.

Testet IRIS mbi gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit në Shqipëri për vitin 2006





- Edhe pse në pamje të parë vihen re tendenca pozitive të treguesve të tregut, në përgjithësi, raporti dëme/prime dhe raporti i shpenzimeve, vazhdojnë të jenë në norma larg të pranueshmes. Kjo është një situatë e mbartur prej vitesh dhe do të jetë në fokusin e Autoritetit për normalizim nëpërmjet hartimit të strategjive të reja të menaxhimit të riskut dhe përmirësimin e kuadrit ligjor që lidhet me dëmet.
- Raporti i kombinuar në pjesën më të madhe të shoqërive është brenda kufijve minimalë dhe maksimalë. Autoriteti do të synojë ruajtjen e raporteve të kombinuara të shoqërive, duke kërkuar ndryshimin e tendencave të pjesëve përbërëse të tij.
- Tek raporti operativ vërejmë se pjesa më e madhe e shoqërive kanë raporte brenda kufijve maksimalë dhe minimalë që duhet të ketë raporti.
- Vihet re se pjesa më e madhe e shoqërive kanë një kthim nga investimi që është më i vogël se norma ndërkombëtare minimale prej 4%, që lidhet kryesisht me masën e aseteve të shoqërive më tepër se me të ardhurat nga primet.
- Përsa i përket kthimit nga të ardhurat e tjera, pjesa më e madhe e shoqërive ka një kthim më të lartë se kufiri normal për këtë raport prej 1%.

Monitorimi i Elementëve të Bilanceve të Shoqërive

Autoriteti ka monitoruar bilancet e shoqërive bazuar në kërkesat ligjore dhe standardet e kontabilitetit. Procesi është përqëndruar në verifikimin e elementëve të pasivitetit (kapitalet dhe përgjegjësitë e çdo shoqërie) dhe më pas në shqyrtimin e përputhjes së tyre me zërat e aktiveve në vlerë dhe kohë.

- AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Aktualisht shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në “depozita qëllimore” në banka të nivelit të dytë me afat 1- vjeçar dhe Bono Thesari, sipas kërkesave të ligjit;
- Autoriteti ka verifikuar në fund të çdo tre-mujori kufirin minimal të marzhit të aftësisë paguese të shoqërive sipas kërkesave të ligjit dhe aftësinë paguese që përbën njëkohësisht edhe kapitalin e tyre dhe format e investimit ;
- Analiza financiare e shoqërive ka përfshirë edhe kontrollin e bazës së të dhënave dhe llogaritjeve të kryera për provigjonet teknike dhe matematike të shoqërive në fund të çdo tre-mujori. Kontrolli prej Autoritetit është shoqëruar me komentet përkatëse dhe vlerësimin për mjaftueshmërinë e provigjoneve. Pas vlerësimit për mjaftueshmërinë, Autoriteti ka kryer verifikimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike;



- Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve në 31.12.2006 kapi vlerën rreth 11,4 miliardë lekë duke shënuar një rritje në masën 11,69%, krahasuar me vitin 2005. Kjo rritje u reflektua kryesisht në investimet në bono thesari dhe pasuri të patundshme, përkatësisht në masët 30.89% dhe 23.97%;
- Depozitat në bankat e nivelit të dytë arritën në rreth 3,3 miliardë lekë, duke përbërë edhe zërin më të lartë të aktiveve të tregut në masën 28.94 % të totalit të aktiveve. Zëri debitor mbetet ende i lartë dhe kap vlerën 1.118.206.723 lekë, duke përbërë rreth 9% të aktiveve në sektorin e sigurimeve;
- Rritja e primeve në sigurimin e detyrueshëm në vitin 2006 ka sjellë një ndryshim pozitiv në situatën financiare të tregut, përmirësim të fluksit të parave (cash – flow), rritje e potencialit investues të shoqërive, çka ka sjellë një përmirësim të cilësisë së aktiveve drejt investimeve likuide duke shtuar garantimin e mbulimit të provigjoneve teknike dhe kapitalit me aktive të cilësisë së lartë.

Tabela 6: Bilanci i Tregut të Sigurimeve

Bilanci	31.12.2005	31.12.2006 (*)
Depozita	3.477.332.193	3.302.423.253
Toka dhe ndërtime	848.259.652	1.051.585.476
Aksione dhe pjesëmarrje	854.111.519	948.707.019
Bono Thesari	1.752.811.221	2.294.279.103
Debitorë	955.121.772	1.118.206.723
Aktive të tjera	2.327.975.749	2.694.262.335
Totali i Aktivit	10.215.612.106	11.409.463.909
Provigjonet Teknike Bruto	4.917.078.725	5.378.670.605
Detyrime të tjera	609.889.355	300.160.934
Kapitalet e Veta	4.688.644.026	5.730.632.370
Totali Pasivit	10.215.612.106	11.409.463.909

(*) Të dhënat e vitit 2006 janë operative

2.3.2 Tregu i Letrave me Vlerë

Tregu i letrave me vlerë vazhdon të dominohet nga tregtimi në tregun primar dhe atë sekondar të instrumenteve të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), ndërsa tregu i letrave me vlerë të aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar dhe i kufizuar kryesisht në tregun informal të aksioneve të kompanive të regjistruara pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.

Vitet e fundit vihet re një rritje e konsiderueshme e interesit të subjekteve të ndryshme vendase

dhe të huaja për t'u licencuar dhe ushtruar aktivitet në tregun vendas të letrave me vlerë.

Aktiviteti mbikëqyrës i Autoritetit në fushën e letrave me vlerë është fokusuar kryesisht në ndjekjen e vazhdueshme të zhvillimit të treguesve të tregut. Gjithashtu, për të pasur një vlerësim sa më real të këtyre treguesve, AMF i ka dhënë prioritet standardizimit të procesit të raportimit periodik që duhet të bëjnë operatorët mbi statistikën e ecurisë së tregut të letrave me vlerë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Borxhit Qeveritar

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është tregu më i zhvilluar i letrave me vlerë në vend. Gjatë viti 2006 ky treg u dominua krejtësisht nga transaksionet në instrumentet afatshkurtër (bonot e thesarit). Zgjerimi i tregut me operatorë të tjerë si dhe thellimi i tregut të letrave me vlerë të Qeverisë me instrumenta borxhi me afat më të gjatë maturimi pritet të rrisë edhe fluksin e transaksioneve në tregun me pakicë të këtyre instrumenteve.

Viti 2006 shënoi një fluks relativisht të kënaqshëm transaksionesh në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i cili ka pësuar rritje në krahasim me vitin paraardhës. Shuma totale e transaksioneve në tregun me pakicë (sekondar) të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2006 ishte rreth 20.912,14 milionë lekë (nga 1.518,80 milionë Lekë që ishte në vitin 2005). Numri total i transaksioneve të kryera në këtë treg gjatë së njëjtës periudhë ishte 6065 nga 742 që ishte në vitin 2005.

Tabela 7: Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2006

Lloji i Transaksionit (ne milione leke)	3 Mujori I		3 Mujori II		3 Mujori III		3 Mujori IV	
	Vlera nominale	Nr. Trans.	Vlera nominale	Nr. Trans.	Vlera nominale	Nr. Trans.	Vlera nominale	Nr. Trans.
1. Blerje ne Tregun Primar								
Individe	2.058,93	992	756,97	272	695,18	239	1.649,37	686
Persona juridike	706,76	17	880,25	13	874,64	14	1.939,81	19
2. Shitje nga Portofoli i Bankës	2.891,33	1445	725,61	305	1.442,17	588	1.460,05	602
3. Blerje nga Individët para Afatit të Maturimit	115,34	74	227,53	138	1.181,27	126	213,33	87
4. Shlyerje e Vlerës Nominale në Maturim	209,36	48	814,77	78	940,89	66	1.094,00	195
5. Vendosje e Letrave me Vlerë të Qeverisë si Kolateral	2,53	2	7,72	18	8,12	18	16,11	23
Totali	5.984,25	2578	3.412,85	824	5.142,27	1051	6.372,67	1612



Kështu, rritja e fluksit të transaksioneve në këtë treg në krahasim me vitin 2005, ka ardhur kryesisht për shkak të decentralizimit të regjistrimit për transaksionet në letra me vlerë të Qeverisë dhe kalimit të këtij aktiviteti tek bankat e licencuara nga AMF për të ushtruar aktivitetin e tyre në tregun me pakicë. Kjo ka rritur tendencën e bankave për t'u ofruar klientëve të tyre një produkt ndryshe nga depozitat. Gjithashtu, eksperiencia ka treguar që një rëndësi të veçantë në rritjen nga vitit në vit të fluskës të transaksioneve në këtë treg ka edhe rritja e sensibilizimit të publikut mbi investimin në letra me vlerë të Qeverisë.

Tregu i Kapitaleve

Tregu i kapitaleve mbetet ende pjesa më e pazhvilluar e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri. Ky treg përbëhet nga tregu zyrtar (Bursa e Tiranës), tregtarët e licencuar për të tregtuar në letra me vlerë dhe tregu informal i transaksioneve mbi aksionet e shoqërive aksionere.

Bursa e Tiranës (BT), e krijuar që në vitin 1996, është shoqëri anonime shtetërore me pronar të vetëm Ministrin e Financave, e licencuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë (sot AMF) si treg i organizuar i letrave me vlerë të borxhit dhe aksioneve. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme, ky institucion nuk ka arritur të bëhet tërheqës për biznesin vendas. Aktualisht, në Bursën e Tiranës nuk ka asnjë shoqëri të listuar dhe tregtimi i letrave me vlerë të Qeverisë në këtë treg është inekzistent.

Kushtet aktuale në të cilat ndodhet ekonomia e vendit, të shoqëruara me nevojën për një rritje të shpejtë e të qëndrueshme çka do të thotë rritje të kërkesave për financime si nga sektori privat ashtu dhe nga ai shtetëror, kërkojnë fillimin sa më shpejt dhe jo shtyrjen, e procesit të zhvillimit të tregut të kapitaleve. Në këtë kontekst, Qeveria mund të luajë një rol të rëndësishëm në drejtim të nxitjes së zhvillimit të këtij sektori kryesisht nëpërmjet privatizimit të një pakete aksionesh të kompanive strategjike shtetërore në tregun e kapitaleve ose nëpërmjet ofrimit të incentivave të ndryshme fiskale e ligjore për të nxitur biznesin vendas të shfrytëzojë këtë treg dhe listimin në bursë si një mjet financimi.

Tregu informal i aksioneve është një treg i paorganizuar, i cili konsiston kryesisht në transaksionet e ekzekutuara mes aksionerëve të shoqërive të privatizuara. Ky treg vazhdon të jetë aktiv ndonëse nga viti në vit ka ardhur në rënie për shkak të konsolidimit të pronësisë në shoqëritë e privatizuara. Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", të gjithat shoqëritë që kanë mbi 50 aksionerë duhet të regjistrohen pranë një regjistri të pavarur e të specializuar. Për rrjedhojë, regjistrimi si dhe pastrimi e rregullimi i llogarive për transaksionet e ekzekutuara në aksione realizohet nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA).

Bursa e Tiranës (BT)

Bursa e Tiranës sh.a., mban licencën për të vepruar si treg i organizuar letrash me vlerë për një periudhë 2 vjeçare, deri më 01.07.2007. Licenca vlen për tregtimin e letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë, të borxhit të shoqërive dhe të aksioneve. Rilicencimi 2-vjeçar është kushtëzuar me detyrën që Bursa duhet të hartojë dhe të raportojë pranë AMF planin për ndërmarrjen e hapave për daljen graduale nga pronësia shtetërore, dhe për përgatitjen e shoqërive potenciale publike për listimin e tyre në BT.

Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA)

Regjistri vepron me licencë që nga viti 2002 me objekt regjistrimin e aksioneve të shoqërive anonime. Shoqëritë anonime me mbi 50 aksionerë kanë detyrimin ligjor për mbajtjen e regjistrimit të aksioneve të tyre pranë një qendre të pavarur regjistrimi. QRA, krahas mbajtjes së regjistrimit, me kryerjen e transaksioneve bën edhe azhurnimin e tij. QRA ofron edhe shërbime të tjera si:

- njoftimi i mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së aksionerëve,
- llogaritjen e dividendëve.

QRA është një shoqëri aksionere, e cila është e licencuara nga AMF si regjistër i letrave me vlerë të pronësisë. Përveç regjistrimit të pronësisë së kompanive në formë elektronike (Book-Entry), QRA ofron edhe shërbime të tjera korporative për shoqëritë e regjistruara. Aktualisht në QRA janë të regjistruara rreth 48 kompani, 15 prej të cilave janë institucione financiare (4 banka, 9 kompani sigurimesh, 1 regjistrar letrash me vlerë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore).

Numri total i shoqërive të regjistruara pranë QRA gjatë vitit 2006 pësoi një rënie prej 31,4% në krahasim me vitin 2005. Nga këto kompani, vetëm ak-

sionet e 18 prej tyre u tregtuan në tregun jashtë bursës. Në këtë treg u realizuan gjithsej 140 transaksione me një nr. total prej 1.637.755 aksionesh nga 554 transaksione të ekzekutuara në vitin 2005 me një nr. total prej 1.002.886 aksionesh. Numri i aksioneve të tregtuara në tregun informal gjatë vitit 2006 përbën rreth 8.89% të të gjithë aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA, çka tregon për shkallën e ulët të likuiditetit që karakterizon këtë treg.

Tabela 8: Statistika mbi Tregun Informal të Aksioneve për vitin 2006

Nr.	Klasifikimi	Statistika
1.	Nr. Total i shoqërive aksionere të regjistruara pranë QRA-së	48
2.	Nr. Total i aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së	18.410.025
3.	Nr. Total i shoqërive aksionet e të cilave janë tregtuar	20
4.	Nr. Total i transaksioneve të ekzekutuara gjatë vitit 2006	140
5.	Nr. Total i aksioneve të tregtuara gjatë vitit 2006	1.637.755
6.	Përqindja e transaksioneve të tregtuara gjatë vitit 2006	8.89 %

Burimi i të Dhënave: Qendra e Regjistrimit të Aksioneve

Është vështirë të bëhet një vlerësim real i ecuresë së tregut informal të aksioneve në Shqipëri, kryesisht për shkak të mungesës së informacionit mbi çmimin e tregtimit të aksioneve, çka pengon në llogaritjen e treguesve realë të vlerësimit të këtij tregu. Gjithashtu, mungesa e informacionit mbi aktivitetin dhe pasqyrat financiare të këtyre kompanive lë shteg për një “deformim” të çmimeve pasi nuk paraqet kërkesën dhe ofertën reale për këto letra me vlerë duke lënë të pambrojtur investitorët e vegjël, zotërues të aksioneve të këtyre shoqërive.



2.3.3 Tregu i Pensioneve Private Suplementare

Zhvillimi i Instituteve të Pensioneve Private Suplementare

Sistemi i pensioneve në Shqipëri është në një nivel të ulët zhvillimi në krahasim me vendet e rajonit. Ky sistem është kryesisht i bazuar në shtyllën e financuar nga shteti, ose siç quhet ndryshe Skema e Sigurimeve Shoqërore (sistemi PAYG, ose pay-as-you-go).

Ekzistenca e kolonës së tretë të pensioneve në Shqipëri është ende në fillimet e saj. Pavarësisht miratimit të ligjit “Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve” që në vitin 1995, aktiviteti i shoqërive të para private në fushën e pensioneve filloi në vitin 2006. Gjatë kësaj periudhe, këto shoqëri i kanë kushtuar kujdes marketingut, punës me punëdhënësit dhe individët për të tërhequr sa më shumë kontribues. Pavarësisht këtij fakti, institutet ekzistuese të pensioneve private, kanë një numër kontribuesish në nivelet

minimale të kërkuara nga kuadri ligjor. Nga ana tjetër, mungesa e kompanive të huaja në këtë treg, për shkak të kufizimeve ligjore, e bën të pandjeshme konkurrencën mes shoqërive vendase. Për vitin 2006, totali i kontribuesve të tregut të pensioneve private suplementare është rreth 2621 kontribues, duke akumuluar një fond prej rreth 13,15 milionë lekë.


Kolona e Tretë

Nënkupton kursime vullnetare individuale dhe kontribute suplementare nga punëdhënësi. Kjo skemë ofron të ardhura suplementare për njerëzit që dëshirojnë të përfitojnë pensione më të larta kur të jenë të moshuar. Eksperienca e shumë vendeve ka treguar se investimi i një pjesë të kursimeve në fondet private të pensioneve, është një mënyrë e mirë investimi për kohën e pensionit. Të ardhurat nga skemat suplementare janë një komponent mjaft i rëndësishëm për ekonominë e të moshuarve.

Të dhënat e tregut sipas shoqërive paraqiten si më poshtë:

- Shoqëria “*Garantsig Instituti Privat i Pensioneve sh.a.*” ka filluar aktivitetin e saj me 01.01.2006. Për periudhën janar – dhjetor 2006, shoqëria ka rreth 892 kontribues me rreth 2,62 milion lekë kontribute.
- Shoqëria “*IAPPSSH sh.a.*” (Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare Shqiptare) ka filluar aktivitetin e saj më 01.01.2006. Për periudhën janar – dhjetor 2006, shoqëria ka 1122 kontribues me rreth 9,27 milion lekë kontribute, të investuara këto në bono thesari.
- Shoqëria *Instituti Privat i Pensioneve “Capital sh.a.”* filloi aktivitetin me 01.03.2006. Për periudhën mars-dhjetor 2006, ky institut mblodhi 1,26 milion lekë kontribute, me rreth 607 kontribues. Kontributet në masën 90% janë investuar në bono thesari, ndërsa pjesa tjetër në depozita bankare.

Struktura e Tregut të Pensioneve Private në vitin 2006



Shoqëritë e Pensioneve Private dhe Suplementare kanë qenë subjekt i mbikëqyrjes në vend nga ana e Autoritetit. Qëllimi i inspektimeve pranë këtyre shoqërive ka konsistuar kryesisht në verifikimin e :

- i) Respektimit të kërkesave ligjore të instituteve të pensioneve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre;
- ii) Investimit të fondit të garancisë;
- iii) Realizimit të të ardhurave nga kontributet e derdhura dhe investimi i tyre;
- iv) Llogarive individuale të aderuesve;
- v) Zbatimit të plan biznesit të hartuar nga Institutet Private të pensioneve.

Perspektiva e zhvillimit të kolonës së tretë

Nisur nga rëndësia që ka kolona e tretë në sistemit e pensioneve si dhe bazuar në kufizimet që ka kuadri ligjor ekzistues për organizimin e kësaj kolone, arrihet në përfundimin se zhvillimi i saj kërkon ndryshime rrënjësore kryesisht në këto drejtime:

- Rishikimi i plotë i kuadrit ligjor. Ligji aktual ka nevojë për përmirësime të ndjeshme, me objektiv përafrimin me standardet ndërkombëtare si dhe përshtatjen me zhvillimet në vend;
- Stimulimi dhe përfshirja në këto skema e punëdhënësve dhe individëve nëpërmjet krijimit të politikave nxitëse ligjore e fiskale;
- Rritjes dhe forcimi i elementëve të garancisë dhe mirëadministrimit të instituteve të pensioneve private;
- Nxitja dhe zhvillimi i tregut të kapitaleve në vend, pasi është i lidhur ngushtë me zhvillimin e tregut të pensioneve.

Ndërmarrja e masave për plotësimin e kushteve të sipërpërmendura do të sjellë domosdoshmërisht rezultate pozitive në tregun shqiptar të pensioneve private suplementare.



2.4 Marrëdhëniet Institucionale

2.4.1 Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka një rol të rëndësishëm për zhvillimin dhe ruajtjen e një stabiliteti të qëndrueshëm financiar për ekonominë e vendit. Në këtë kontekst, është punuar për krijimin e një fryme pozitive bashkëpunimi me institucione të rëndësishme financiare në vend si Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, AMF është një partner serioz për Qeverinë në funksion të përshejtit të reformave që kanë lidhje me zhvillimin e sektorit financiar jobankar. Gjatë vitit 2006, Autoriteti ka bashkëpunuar edhe me institucione të tjera brenda vendit për përmirësimin dhe koordinimin e punës me grupet e interesit, që lidhen me veprimtarinë e tij.

Një element i rëndësishëm i bashkëpunimit institucional është edhe nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit dhe Mirëkuptimit ndërmjet AMF-së dhe institucioneve të tjera rregulluese në vend. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është koordinimi i punës rregullative mes enteve rregullatore të fushave të ngjashme si dhe shkëmbimi i informacionit me institucione të tjera të rëndësishme për zhvillimin e vendit (shih Tabelën 9).

Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar (GKSF)

Neni 30 i ligjit Nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" specifikon qartë ngritjen dhe funksionimin e një strukture të re, Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar (GKSF), e cila:

- Synon bashkërendimin e punës mbikëqyrëse e rregulluese dhe asiston në zhvillimin e politikave të përbashkëta në sistemin financiar të vendit,
- Siguron shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve financiare, anëtare të grupit,
- Asiston në ruajtjen, stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë si dhe në përmirësimin e rritjen e efikasitetit të kontrollit mbi pjesëmarrësit e këtyre tregjeve

Anëtarë të GKSF

- Ministri i Financave;
- Kryetari i Bordit të AMF;
- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë

Në muajin dhjetor 2006, AMF ka nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi me Autoritetin e Konkurrencës. Objekti i kësaj marrëveshjeje është sigurimi i asistencës reciproke në drejtim të shkëmbimit të informacionit. Marrëveshja synon vendosjen e rregullave dypalëshe, për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në zbatim të politikave jo diskriminuese, për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushat që AMF ushtron funksionet e veta mbikëqyrëse dhe rregulluese.



2.4.2 Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare

Zhvillimi i tregjeve ndërkombëtare financiare me ritme të shpejta, unifikimi i standardeve rregulluese dhe mbikëqyrëse si dhe angazhimi i rregullatorëve të vendeve përkatëse për zbatimin e këtyre “parimeve të përgjithshme”, ka bërë që AMF të intensifikojë kontaktet dhe shkëmbimin e eksperiencave me homologët si dhe të vlerësojë pjesëmarrjen në organizmat ndërkombëtarë si një detyrë parësore. Bashkëpunimi ndërkombëtar bëhet më intensiv për shkak të nevojës së futjes në zbatim të Direktivave të BE-së dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Tabela 9: Anëtarësime dhe Marrëveshje Bashkëpunimi të Nënshkuara

A. Marrëveshje të Nënshkuara me Organizata Brenda Vëndit	Viti	Institucioni
- Fakulteti i Ekonomisë	2002	KLV (sot AMF)
- Instituti i Ekspertëve Kontabël (IEKA)	2003	KLV (sot AMF)
- Drejtoria e e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	2003	AMS (sot AMF)
- Banka e Shqipërisë	2005	AMS, KLV (AMF)
- Autoriteti i Konkurrencës	2006	AMF
B. Marrëveshje të Nënshkuara me Institucione Homologe Jashtë Vëndit	Viti	Institucioni
- Komisioni i Tregut të Kapitaleve të Greqisë	1999	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë të Quebec-ut	2000	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Italisë	2000	KLV (sot AMF)
- Agjencia e Tregut të Kpitaleve të Sllovenisë	2003	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Polonisë	2003	KLV (sot AMF)
- Bordi i Tregut të Kapitaleve i Turqisë	2003	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Mbikëqyrjes së Tregut Financiar i Bullgarisë	2003	KLV (sot AMF)
- Autoriteti Bankar dhe Pagesave i Kosovës	2004	AMS (sot AMF)
- Komisioni Kombëtar i Letrave me Vlerë i Rumanisë	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Maqedonisë	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Malit të Zi	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë i Kroacisë	2005	KLV (sot AMF)
C. Anëtarësime në Organizma Ndërkombëtare të Rregullatorë ve	Viti	Institucioni
- IOSCO (Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë)	1998	KLV (sot AMF)
- IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve)	2001	AMS (sot AMF)
- IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve)	2006	AMF



Anëtarësimi në Organizatat Ndërkombëtare

AMF është anëtar me të drejta të plota në organizatat ndërkombëtare të rregullatorëve të fushave të sigurimeve, letrave me vlerë, të trashëguara nga autoritetet përkatëse të mëparshme dhe fondeve të pensioneve e nënshkruar rishtaz nga AMF. Pjesëmarrja aktive në këto organizma ka për synim rritjen e bashkëpunimit shumëpalësh në funksion të rregullimit sa më efektiv të këtyre tregjeve në nivel ndërkombëtar. Ky bashkëpunim, ka konsistuar në shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave, bashkërendimin e përpjekjeve për përcaktimin e standardeve të rregullimit e mbikëqyrjes si dhe sigurimin e një asistence të përbashkët për ruajtjen e integritetit të tregjeve financiare jobankare.

Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) - Anëtarësimi në këtë organizatë ka ndihmuar Autoritetin kryesisht në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullativ të fushës së sigurimeve me standardet ndërkombëtare si dhe në drejtim të zbatimit të këtij kuadri në praktikë. Në këtë këndvështrim, AMF ka pasur kontakte të vazhdueshme me organizma të ndryshme të IAIS, nëpërmjet pjesëmarrjes së vazhdueshme në trainime, seminare, konferenca, si dhe në mbledhjet vjetore të anëtarëve të kësaj organizate.

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) - Me statusin e anëtarit të IOSCO-s, gjatë vitit 2006, Autoriteti ka vazhduar bashkëpunimin e tij me këtë organizatë duke marrë pjesë në Komitetet dhe Grupet e Punës të ngritura për çështje të ndryshme. Gjithashtu, AMF ka synuar të bëhet palë në Marrëveshjen Shumëpalëshe të Mirëkuptimit dhe Metodologjisë së Vlerësimit (MMOU), e nënshkruar nga shumica e vendeve të zhvilluara anëtare të IOSCO-s. Kjo marrëveshje ka për qëllim, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, vendosjen e rregjimit të shkëmbimit të informacionit që të arrihet një mbikëqyrje sa më efikase mbi operatorët dhe shërbimet financiare të tregjeve të kapitalit në shkallë globale. Deri në vitin 2010, AMF duhet të ketë përbushur të gjitha përshtatjet ligjore e rregullatore e t'i jetë nënshtruar vlerësimit për t'u pranuar për nënshkrimin e MMOU-së. Ky fakt përbën dhe një kusht për të qenë anëtar i organizatës. I njëjti proces ndodh edhe për MMOU-në në IAIS. Kjo e vë AMF-në para përgjegjësive madhore për rishikimin e gjithë paketës ligjore të fushave nën juridiksion.

Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) - Menjëherë pas krijimit si një institucion i ri rregullator, AMF filloi procedurat për anëtarësimin në Organizatën Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) duke u bërë anëtarë e saj me të drejta të plota në muajin dhjetor 2006. Qëllimi i funksionimit të kësaj organizate është nxitja dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e rregullimit të tregut të pensioneve. Gjithashtu, IOPS shërben si një forum i hapur për diskutimim e politikave të zhvillimit të këtij tregu si dhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe informacioneve.

Bashkëpunimi me Institucione Homologe

AMF ka vazhduar marrëdhëniet e mira dypalëshe me Autoritete të ngjashme që rregullojnë dhe mbikëqyrin tregjet financiare jobankare në vendet respektive. Këto përpjekje

janë materializuar me nënshkrimin e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit (Memorandum of Understanding) me shumë Autoritete homologe. Përfitimi kryesor i nënshkrimit dhe zbatimit të këtyre marrëveshjeve, është vendosja e marrëdhënieve dypalëshe për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit konfidencial si një mjet kryesor për një funksionim të lehtë, të shpejtë dhe eficient të praktikave më të mira ndërkombëtare të rregullimit të tregjeve financiare. Në vijim të kësaj fryme pozitive, Autoriteti është duke punuar për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione të ngjashme nëpërmjet hartimit të disa marrëveshjeve të reja me disa nga vendet e zhvilluara.

Bashkëpunimi me Partnerët (Donatorët)

Donatorët kanë qenë partnerë seriozë dhe një faktor mbështetës shumë i rëndësishëm si për ngritjen institucionale të Autoritetit, ashtu edhe për nxitjen dhe zhvillimin e hallkave të veçanta të aktivitetit të këtij institucioni.



Bashkëpunimi me Bankën Botërore (BB) – si partneri kryesor dhe më i rëndësishëm, BB ka ndihmuar dhe mbështetur të gjithë procesin e unifikimit të rregullatorëve dhe ngritjen institucionale të AMF-së gjithashtu, BB ka siguruar një mbështetje reale edhe në drejtim të organizimit të një sistemi trainimesh nga ekspertë dhe lektorë të njohur ndërkombëtarë, të cilët kanë patur për qëllim rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe kualifikimin e mëtejshëm për çështje specifike jo vetëm të stafit të AMF-së, por edhe të operatorëve të tregut financiar jobankar.

Bashkëpunimi me FSVC (Financial Services Volunteer Corps) – Ka qenë efikas kryesisht në drejtim të hartimit të politikave menaxhuese të burimeve njerëzore si dhe në drejtim të trainimit të specialistëve të një fushe mjaft specifike të tregut të sigurimeve siç është aktuaristika.

Bashkëpunimi me Bankën Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) – Është fokusuar në drejtim të hartimit të kuadrit të nevojshëm ligjor për emetimin e letrave me vlerë të borxhit të shoqërive aksionere (corporate bonds) si dhe letrave me vlerë të borxhit të qeverisjes lokale (municipal bonds).



Aktivitete, Konferenca dhe Trainime

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare dhe bashkëpunimin me Autoritete homologe, konsiderohet si një mundësi për shkëmbim eksperiencash, rrahje mendimesh mbi probleme të përbashkëta si dhe për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet kualifikimeve të ndryshme. Në



këtë vështrim Autoriteti ka shfaqur interes nëpërmjet një pjesëmarrjeje aktive në takime, konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakta, takime vjetore si dhe trainime të ndryshme të organizuara në nivel rajonal dhe ndërkombëtar dhe ku janë shtjelluar çështje të zhvillimit dhe rregullimit të tregjeve të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensione.

2.4.3 Politikat e Marrëdhënieve me Publikun

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e konsideron shumë të rëndësishëm informimin e publikut me qëllim mbrojtjen sa më mirë të interesave të konsumatorëve. Për këtë arsye, një vëmendje e veçantë i kushtohet transparencës së aktivitetit mbikëqyrës e rregullues të AMF-së si dhe mundësimit të marrjes së informacionit nga ana e publikut. Në këtë kuadër, pas krijimit të saj AMF ka vazhduar praktikën e suksesshme të enteve rregullatore paraardhëse për publikimin e raporteve periodike informative dhe statistikore mbi zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të tregut jobankar.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar prezantimit të AMF-së në median e shkruar dhe elektronike kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe seminare ku diskutohen çështje të rëndësishme që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë Shqiptare. Gjithashtu, me qëllim qëndrimin më pranë publikut, ka nisur puna për faqen zyrtare të internetit të AMF-së, e cila do të jetë një mjet i rëndësishëm komunikimi për përfaqësimin dinjitoz të imazhit e këtij enti rregullator në publik.

2.5 Teknologjia e Informacionit

AMF është duke përpunuar një strategji për zhvillimin e Informacionit dhe Teknologjisë (IT) në vetvete dhe në treg, me qëllim përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut dhe operatorëve të tij nëpërmjet implementimit të modelit të mbikëqyrjes me bazë risku. Me qëllim plotësimin me efikasitet të detyrimeve ligjore, Autoritetit i nevojitet një Sistem Informatike i Integruar, i cili plotëson dhe përpunon të tërë informacione e nevojitur si pjesë e aktivitetit të institucionit, ndërkohë që garanton stabilitet, siguri dhe vazhdueshmëri të proceseve të punës.

Avantazhet e një sistemi të tillë janë si më poshtë:

- Ngritja e një baze të të dhënave për tërë tregun e sigurimeve që do të përdoret jo vetëm në monitorimin e përditshëm të shoqërive të sigurimit, apo në inspektimet në vend, të kryera nga inspektorët, por edhe nga vetë shoqëritë për shmangien e mashtrimeve, rastet e falsifikimeve apo në një të ardhme përdorimin e metodave më efektive në ven-

- dosjen e primeve në bazë të historikut të policëmbajtësit;
- Minimizimi i gabimeve teknike nga ana e ekspertëve për shkak të përdorimit të platformave të ndryshme, i cili do t'i japë besueshmëri më të madhe informacionit të nxjerrë nga Autoriteti;
 - Automatizimi i proceseve të punës dhe shkurtimi i kohës së nevojitur nga specialistët e departamenteve të ndryshëm të Autoritetit për përpunimin e informacionit të marrë gjatë ditës si dhe në mënyre periodike, si dhe do të shkurtojë akoma dhe më shumë qarkullimin e dokumenteve;
 - Përdorimi i “paketave software” të standardizuara në aktivitetin financiar të AMF-së dhe të njohura nga organet e kontrollit apo ato tatimore, rregullon dhe bën më transparent funksionimin e vetë Autoritetit;
 - Informatizim i arkivës si dhe tërë dokumentacionit të protokolluar për të lehtësuar dhe mundësuar vazhdueshmërinë e përpunimit të materialeve me afate shqyrtimi relativisht të gjata;
 - Regjistrat e subjekteve në aktivitetin financiar jobankar janë në proces informatizimi;
 - Efektivitet më i lartë në përdorimin e burimeve njerëzore, duke minimizuar procesin e hedhjes së të dhënave manualisht nga ekspertët dhe përdorimin e këtyre burimeve në nxjerrjen e produkteve më të avancuara;
 - Një mundësi e përdorimit të rakordimit të të dhënave statistikore nga ky database me të dhënat financiare si dhe bashkëpunim me institucione simotra që janë të lidhura me tregjet financiare;
 - Përlllogaritja e provigjoneve teknike, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit do të përforcojnë kontrollin e fondeve të shpenzuara nga subjektet që operojnë në treg;
 - Do të përlllogaritet me saktë rreziku i ndërmarrë në sigurime apo në investime;
 - Do të qartësohet më shumë diversifikimi i portofoleve të subjekteve.

III. Fokusi për të Ardhmen



Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e të gjitha rregullave. Fokusi kryesor i Autoritetit në të ardhmen do të jetë rregullimi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme profesionale e sektorit financiar jobankar, çka do ndikojë në rritjen e ndjeshme të peshës dhe rolit të sigurimeve, pensioneve private suplementare dhe letrave me vlerë në tregun financiar dhe ekonominë Shqiptare në tërësi dhe do t'i shërbejë në të njëjtën kohë forcimit të stabilitetit financiar dhe makroekonomik të vendit.

Rishikimi i legjislacionit në përputhje me nevojat e zhvillimit dhe përafrimin me direktivat e Bashkimit Europian (BE) përbën një nga prioritetet bazë të institucionit drejt rregullimit të tregjeve sipas standardeve ndërkombëtare. Rritja e fondit të garancisë për shoqëritë e sigurimeve, e miratuar tashmë nga Kuvendi, apo përfshirja e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS) brenda vitit 2008, do të pasohen nga nisma të tjera të AMF-së për ndryshime dhe shtesa në kuadrin ligjor në përputhje me direktivat e BE-së. Kuadri ligjor i përmirësuar do të synojë krijimin e një ambienti më të sigurt të veprimtarisë së operatorëve në tregjet e mbikëqyrura. Nga ana tjetër, AMF do të bashkëpunojë ngushtë me të gjithë strukturat për përshtatjen harmonike të legjislacionit me stadin e zhvillimit dhe kërkesat e tregjeve, si edhe për zbatimin në kohë dhe me efektivitet të rregullave të vendosura.

Kalimi nga modeli i mbikëqyrjes tradicionale në atë me bazë risku, mbështetur në praktikën e vendeve Europiane, do të përbëjë prioritetin e AMF-së në planin e mbikëqyrjes. Përjasja e re e mbikëqyrjes së bazuar në risk parashikohet të mbështetet nga një sistem i ri elektronik i raportimit, që do të garantojë komunikim të shpejtë dhe të besueshëm, rritje të kapacitetit të analizës, përmirësim të sistemit të paralajmërimit dhe përfundimisht, rritje të cilësisë dhe efikasitetit të të gjithë veprimtarisë mbikëqyrëse të institucionit. Tashmë Autoriteti është në fazën e komunikimit me institucione homologe në Europë për të shqyrtuar modele të ndryshme të sistemeve dhe efektivitetin që ato kanë në ecurinë e mbikëqyrjes në vendet përkatëse. Hartimi dhe rishikimi i dokumentave dhe procedurave të brendshme të punës së AMF-së që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen në vend, apo procesin të mëtejshëm të analizës sipas modelit me bazë riskun, do të shoqërojë zbatimin e modelit të ri të mbikëqyrjes.

Promovimi dhe nxitja e zhvillimit të tregjeve dhe e produkteve e shërbimeve financiare jobankare të ofruara në to do të mbeten në fokusin e punës së Autoritetit për periudhën në vijim. Një objektivi i tillë do të realizohet jo vetëm nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së produkteve e shërbimeve ekzistuese të ofruara, por edhe nëpërmjet shtimit të gamës së tyre në përputhje me nevojat e konsumatorëve. Cilësia e qeverisjes së shoqërive mbetet gjithashtu një faktor kyç në përmirësimin e menaxhimit të rrezikut dhe zvogëlimit të kostove administrative që aktualisht paraqesin operatorët në treg. AMF do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë rritjes së cilësisë së qeverisjes së shoqërive aksionere. Qëllimi ynë është të garantojmë aftësinë, mundësinë dhe dëshirën e mirë në drejtimin e operatorëve të

mbikëqyrur. Edukimi dhe rritja e vëmendjes së konsumatorëve ndaj produkteve të ofruara nga operatorët e mbikëqyrur do të jetë pjesë e një fushate të gjerë që do të nisë AMF në bashkëpunim me operatorët e tregut. Qëllimi i kësaj fushate do të jetë ndërgjegjësimi në shkallë të gjerë i popullsisë mbi rëndësinë dhe rolin e sigurimeve, pensioneve suplementare, apo produkteve të tjera financiare në garantimin e gjendjes financiare të familjeve apo bizneseve shqiptare dhe rritjen në vijim të cilësisë së jetës në Shqipëri.


Arritja e të gjithë objektivave të AMF-së në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes do të mbështetet në bashkëpunimin e ngushtë me të gjitha strukturat e tregjeve të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare. Në bashkëpunim me biznesin synohet të realizohen projekte që do të promovojnë efikasitetin dhe integritetin e tregjeve të mbikëqyrura. Fryma e bashkëpunimit dhe komunikimi periodik i nisur me shoqatën e siguruesve do të shkojë më tej me iniciimin dhe zbatimin e projekteve për rritjen e gamës së produkteve, sigurimin e katastrofave natyrore, etj.

Në përfundim, shfaqja makroekonomike solide e vendit, tendenca e rritjes së shpejtë të sektorit bankar, e parë ngushtë me potencialet e mëdha që ofrojnë tregjet e sigurimeve, pensioneve dhe letrave me vlerë në Shqipëri, janë faktorë që mbështesin rritjen e shpejtë dhe të sigurtë të tregjeve financiare jobankare brenda një periudhe të shkurtër. Këta faktorë, të shoqëruar me përmirësimin e mbikëqyrjes së tregjeve financiare në tërësi, kanë shërbyer në këtë periudhë si bazë për tërheqjen e interesit për investim nga shoqëri ndërkombëtare me reputacion, kryesisht në sektorët e sigurimeve dhe pensioneve suplementare. Është për t'u përmendur që shoqëri të huaja të sigurimeve, nga më të mirat në Europë, kanë filluar bashkëpunimin me shoqëri shqiptare të sigurimeve, ndërkohë që interes i madh është shfaqur nga tregjet ndërkombëtare edhe për privatizimin e plotë të INSIG-ut që është planifikuar të realizohet brenda vitit 2007. Përfshirja e praktikave më të mira ndërkombëtare, e kombinuar me një përjasje moderne të rregullimit dhe të mbikëqyrjes do të kenë padyshim një rol shumë të madh në rritjen e kapacitetit të tregut financiar jobankar dhe sigurinë e përsosjen e tij në përgjithësi.

IV. Shtojcat



SHTOJCA A: Struktura Organizative e AMF



Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004	Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime	Objekt i këtij ligji është vendosja e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në këtë ligj.
Dekret nr.295, date 15.09.1992 i ndryshuar me ligjin nr.7461, datë 1.12.1992, me ligjin nr. 8729, datë 18.01.2001	Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësi ndaj personave të tretë	Ligji vendos detyrime për sigurimin e detyrueshëm dhe përgjegjësitë ndaj palëve të treta në rastet e aksidenteve duke parashikuar procedura për përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe parashikon gjithashtu krijimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe procedurat e funksionimit dhe aktivitetit të saj.
VKM nr.191, datë 25.03.2005	Për miratimin e medotikës mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit si dhe elementët që e përbëjnë atë	Në vendim përcaktohet mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit si dhe elementët që e përbëjnë atë.
VKM nr.192, datë 25.03.2005	Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre.	Vendimi përcakton kriteret profesionale dhe të besueshmërisë së agjentëve në sigurime si dhe parashikon procedura për licencimin dhe rregulla për mbikëqyrjen e veprimtarisë së agjentëve.
VKM nr.268, datë 28.04.2005	Mbi përcaktimin e kufijve maksimale të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në shoqëritë e sigurimit	Përcaktohen kufijtë maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në shoqëritë e sigurimit.
Urdhër i Ministrit të Financave nr. 11 datë 25.03.2005	Për miratimin e primit të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta	Ky urdhër përcakton tarifat e primit të pastër për sigurimin e detyrueshëm nga mbajtësit e automjeteve për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.
Urdhër i Ministrit të Financave nr. 14 datë 06.05.2005	Mbi shitjen e dhe administrimin e Policave kufitare nga Byroja Shqiptare e Sigurimit	Objekt i këtij urdhëri është prodhimi, shitja dhe administrimi i Policave të Sigurimit Kufitar, veprime të cilat i ngarkohen Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për llogari të shoqërive të sigurimit anëtare të saj.
Rregullore miratuar me vendimin nr. 4 datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit	Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekulibrit për aktivitetin e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe të respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrese.
Rregullore miratuar me vendimin nr.5, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Mbi përmbajtjen e programit të risigurimit të shoqërive të sigurimit dhe afatet kohore të paraqitjes pranë AMF	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat bazë për hartimin e programit të nevojave për risigurim për çdo vit financiar të shoqërisë së sigurimit.



Rregullore miratuar me vendimin nr. 6, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në AMF	Objekti i kësaj rregulloreje janë rregullat e vendosura nga AMF për mënyrën e raportimit të shoqërive të sigurimit.
Rregullore miratuar me vendimin nr. 7, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit	Objekti i kësaj rregullore është të përcaktohen kriteret dhe procedurat për shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, që do të emërohen nga shoqëritë e sigurimit pas aprovimit nga Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare dhe përmbajtja e raporteve të kontrollit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar.
Rregullore miratuar me vendimin nr. 8, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike	Objekti kësaj rregulloreje është mënyra e llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve matematike nga shoqëritë e sigurimit.
Rregullore miratuar me vendimin nr. 9, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës	Objekti kësaj rregulloreje është mënyra llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës nga shoqëritë e sigurimit.
Rregullore miratuar me vendimin nr. 13, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për procedurat e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë	Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari si shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe degë e shoqërisë së sigurimit të huaj, procedurat e krijimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë nga shoqëria e huaj e sigurimit si dhe procedurat për licencimin e zgjerimit të veprimtarisë së sigurimit të shoqërisë së sigurimit.
Rregullore miratuar me vendimin nr. 14, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për disa kriteret që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizimin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e shoqërisë së sigurimit si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.
Udhëzim miratuar me vendimin nr. 10, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për listën e dokumentave të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit	Objekti i këtij udhëzimi është listimi i të gjithë dokumentacionit të detyruar për dhënien llogari, në mënyrë periodike dhe vjetore ndaj AMF, të shoqërive të sigurimit.
Udhëzim miratuar me vendimin nr. 11, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatore	Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për publikimin e të dhënave të nevojshme për të bërë të mundur njohjen nga publiku të gjëndjes financiare të shoqërive të sigurimit dhe për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë së sigurimit për pagimin e dëmshpërblimeve dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera dhe përcaktimi i rregullave për dhënien e informacionit konsumatorit përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, ose gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.
Udhëzim miratuar me vendimin nr. 12, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për përcaktimin e kriterëve të shoqërive të risigurimit me të cilat shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë mund të lidhin marrëveshje risigurimi	Ky udhëzim ka si objekt rregullimin e veprimtarisë risiguroese të shoqërive të sigurimit, që mund të risigurojë pjesë të përgjegjësisë që ka kontraktuar me të siguruarit, me shoqëritë risiguroese vendase, degë të shoqërive risiguroese të huaja të licencuara nga Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare ose shoqëri risiguroese të huaja që plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë udhëzim.

Në Fushën e Letrave me Vlerë

Referenca Ligjore/Rregullative Emërtimi Përshkrimi i Ligjit/Rregullores

Ligji 8080 datë 01.03.1996 ndryshuar me ligjet 8168, datë 5.12.1996 dhe 8745, datë 22.02.2001	Për Letrat me Vlerë	Ligji për Letrat me Vlerë, është baza kryesore rregulative për veprimtarinë e entit rregullator për fushën e letrave me vlerë. Objekti i ligjit është krijimi i sigurisë për investitorët e letrave me vlerë pikërisht nëpërmjet krijimit të entit rregullator, rregullimit të tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së subjekteve që përfshihen në tregtimin e tyre, si edhe nëpërmjet kontrollit të emetimit publik dhe tregimit të letrave me vlerë. Me anën e këtij ligji, enti rregullator krijohet si një institucion me autoritet mbikëqyrës dhe licencues për tregun e letrave me vlerë dhe, me zhvillimet e këtij të fundit, merr atributet e një institucioni të pavarur.
VKM 440 datë 17.06.2001	Për rregullat për formën dhe përmbajtjen e njoftimeve në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë	Në këtë vendim përcaktohen rregulla në lidhje me subjektet që kanë të drejtë të bëjnë publikimet për letrat me vlerë dhe përjashtimet nga ky rregull, rregullat në lidhje me urdhrat, që mund dhe duhet të nxjerrë enti rregullator në rastet kur gjykon se një publikim në letrat me vlerë është mashtrues, detyrimin për dërgim të kopjeve të publikimeve në adresë të rregullatorit, si dhe sanksionet për rastet që verifikohen se vijnë në kundërshtim me këtë vendim.
VKM 441 datë 17.06.2001	Për rregullat e drejtimit në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë	Qëllimi i vendimit është të parashikojë një etikë, mënyrë sjellje të personave të licencuar për të vepruar në tregun e letrave me vlerë. Përcaktohen në të detyrimet në raport me klientët, detyrimi për komunikim të qartë dhe të ndershëm, detyrimi për të sqaruar klientin në lidhje me risikun, detyrimi për t'i bërë klientit të njohura tarifat e përdorura, etj. Përcaktohen gjithashtu rregulla në lidhje me ekzekutimin me përparësi të urdhrave të klientit, regjistrimin e shpejtë dhe të drejtë të transaksionit të ekzekutuar etj.
VKM 442 datë 17.06.2001	Për kërkesat financiare dhe ato kontabël të pjesëmarrësve në tregun e letrave me vlerë	Në vendim përcaktohen detyrimet në mbajtjen e regjistrimeve kontabël, rinovimi dhe ruajtja e tyre, detyrimi për përgatitjen e pasqyrave financiare, forma dhe përmbajtja e tyre. Jepet përcaktimi "para të klientit" dhe operacionet e lidhura me to. Gjithashtu parashikohet detyrimi i personit të licencuar për të emëruar ekspertë kontabël, duke përcaktuar kompetencat e tyre dhe procedurat e emërimit dhe shkarkimit të tyre.
Rregullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF	Për Licencimin, Kuotat dhe Komisionet	Qëllimi i rregullores është përcaktimi i procedurave të licencimit si edhe kuotat për të cilat detyrohen subjektet rast pas rasti sipas llojit të veprimtarisë për të cilën aplikojnë.
Rregullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF	Për kërkesat për burimet financiare të personave të licencuar	Në të vendosen rregulla përsa i përket kapitalit minimal, kufirit minimal të likuiditetit, detyrimet e personave të licencuar, përkufizimet në lidhje me mjetet e aprovuara dhe mjetet likuide si dhe vlerësimi i tyre.
Rregullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF	Për detyrimin për përgatitjen e prospektit	Nëpërmjet saj përcaktohen rregullat e zbatueshme për ofertat publike të letrave me vlerë, që janë aksione, letra me vlerë të borxhit ose garanci, duke dhënë përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm. Në të jepet forma e detyrueshme dhe përmbajtja e prospektit. Vendosen të dhënat që duhet të përbëjnë pjesën përshkuese të një prospekti të tilla si personat përgjegjës, këshilltarët, të dhënat mbi letrat me vlerë me të cilat lidhet oferta, informacione të përgjithshme mbi emetuesin dhe kapitalin e tij etj. Gjithashtu rregullohen në mënyrë të detajuar procedurat për regjistrimin e prospektit, vendosen afati maksimal i një oferte publike, detyrimi për raportim në Autoritetin e emetuesit pas mbylljes së ofertës dhe masat për eliminimin e parregullsive gjatë ofertës publike.

<p>Rregullore miratuar me vendimin nr. 12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Për marrjen e paketës kontrolluese të aksioneve</p>	<p>Rregullorja krijon bazë ligjore dhe gjen zbatim në të gjithë ofertat për marrjen e paketës kontrolluese të aksioneve apo për bashkimin e shoqërive aksionere të regjistruara në Shqipëri. Objektiv i saj është sigurimi i një trajtimi të drejtë dhe të barabartë të aksionerëve, që preken nga transaksionet për marrjen e paketës së aksioneve. Me anë të kësaj rregulloreje imponohen rregullat e lojës. Oferta për marrjen e paketës kontrolluese duhet të bëhet brenda kohës së përcaktuar, me qëllim që t'u jepet aksionerëve mundësia për të marrë një vendim të mirëinformuar. Publiku ka të drejtë të informohet për çdo ndryshim të rëndësishëm (më shumë apo më pak se 20% të të drejtave të votës).</p>
<p>Rregullore miratuar me vendimin nr. 12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Për licencimin e regjistruarve të letrave me vlerë</p>	<p>Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave, procedurave dhe afateve të licencimit të personave që aplikojnë për t'u pajisur me licencë për të kryer veprimtari si regjistruar të letrave me vlerë. Regjistruesi i letrave me vlerë është personi juridik i licencuar nga Autoriteti që ka për objekt të aktivitetit, organizimin dhe administrimin e regjistrave të letrave me vlerë.</p>
<p>Rregullore miratuar me vendimin nr. 12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Për organizimin e provimit të aplikantëve</p>	<p>Rregullorja përcakton procedurën e organizimit të provimit për tregtarin e letrave me vlerë, këshilltarin e investimeve dhe përfaqësuesit e tyre.</p>
<p>Rregullore miratuar me vendimin nr. 12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Për licencimin e tregtarit të letrave me vlerë</p>	<p>Rregullorja ka për objekt të saj përcaktimin e kërkesave, afateve dhe procedurave të licencimit që duhen ndjekur nga subjektet që aplikojnë për t'u pajisur me licencë për të vepruar si treg letrash me vlerë. Në këtë kuadër, përcaktohet se asnjë subjekt nuk mund të zhvillojë aktivitet si treg letrash me vlerë nëse nuk është licencuar me parë nga Autoriteti. Tregu i letrave me vlerë (Bursa) e organizon veprimtarinë e tij mbi bazë të statutit dhe rregullave të funksionimit të tregut, të cilat i nënshtrohen miratimit nga ana e Autoritetit.</p>
<p>Rregullore miratuar me vendimin nr. 12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Për licencimin e tregtarit të letrave me vlerë, këshilltarit të investimeve dhe përfaqësuesve të tyre</p>	<p>Në rregullore parashikohen qartë aktivitetet për të cilat licencohet tregtari i letrave me vlerë këshilltari i investimeve dhe përfaqësuesit e tyre. Kriteret e licencimit zënë një pjesë të veçantë dhe të konsiderueshme të rregullores. Në të përkufizohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që aplikuesit duhet të paraqesin në mënyrë që të licencohen për veprimtaritë objekt të rregullores. E drejta e AMF për të lëshuar apo refuzuar kërkesat e aplikuesve gjen zbatim në procedurat që ndiqen në një proces të tillë. Gjithashtu në të parashikohen kuotat dhe komisionet që duhet të paguajnë subjektet e licencuar si në momentin e aplikimit, për marrjen e licencës si edhe gjatë ushtrimit të aktivitetit për të cilin kanë siguruar licencën.</p>
<p>Rregullore miratuar me vendimin nr. 12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Për praktikantët e paligjshme të tregtimit</p>	<p>Rregullorja reflekton orientimet më të fundit të KE mbi abuzimet me tregun dhe mbrojtjen ndaj tyre. Rregullorja përcakton definicionin e informacionit të brendshëm, duke përcaktuar qartë dy elementët kryesorë të tij që janë natyra e saktë dhe ndikimi në çmim. Njëpër një këtyri definicioni konsiderohet abuzim me tregun edhe nëse personi që ka kryer veprimin nuk ka pasur përfitim. Për emetuesin e letrave me vlerë për herë të parë vendosën detyrime të tilla si hartimi i listës së personave me akses ndaj informacionit të brendshëm, azhormimi i saj dhe transparencja e transaksioneve të kryera nga drejtorët e shoqërisë dhe personat e lidhur me to ndaj Autoritetit. Gjithashtu parashikohen masa parandaluese të cilat lidhen me detyrimet e personave profesionalisht të angazhuar me transaksionin për denoncimin e një praktike të paligjshme dhe detyrimet e gazetarëve dhe analistëve financiarë për të bërë transparent konfliktet e interesit në artikujt dhe analizat në lidhje me letrat me vlerë.</p>



<p>Rregullore miratuar me vendimin nr.5, datë 07.12.2006 të Bordit të AMF</p> <p>Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të tregut me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë</p>	<p>Kjo rregullore, përcakton qartësisht mënyrën e funksionimit të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, procedurat e monitorimit dhe të transparencës me synim mbrojtjen e investitorëve që investojnë në këto instrumente. Rregullorja jep përcaktimin e saktë të tregut me pakicë, llojet e transaksioneve të këtij tregu, procedurat e tregimit, të mbajtjes së regjistrit analitik, detyrimet për informim dhe raportim pranë Autoritetit. Rregullorja ndalon aktivitetin e tregimit në tregun me pakicë të bankave të palicencuara nga Autoriteti. Bankat që marrin pjesë në tregun me pakicë duhet të organizojnë edhe mbajtjen e regjistrit analitik të letrave me vlerë të Qeverisë, duke marrë licencë për këtë lloj aktiviteti, ose duke lidhur marrëveshje me një bankë tjetër të licencuar për këtë qëllim.</p>
<p>Rregullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Objekt i kësaj rregulloreje është parashikimi i kushteve, mënyrës dhe procedurave për monitorimin e subjekteve të licencuar nga Autoriteti për tregtimin dhe mbajtjen e regjistrit të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Kjo rregullore synon mbrojtjen e interesave të investitorëve të letrave me vlerë dhe përmirësimin e kushteve të funksionimit të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.</p>

Në Fushën e Pensioneve Private Suplementare

Referenca Ligjore/Rregulative	Emërtimi	Përshkrimi i Ligjit/Rregullores
<p>Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 i ndryshuar me ligjin nr. 8393, datë 02.09.1998 dhe ligjin 9181, datë 05.02.2004</p>	<p>Për pensionet suplementare dhe Institutet private të pensioneve</p>	<p>Objekti i këtij ligji është të rregullojë sigurimin e pensioneve private nga institutet private të pensioneve, veprimtarinë për krijimin, licencimin dhe kontrollin e tyre.</p>
<p>VKM nr. 908, datë 29.12.2004</p>	<p>Për procedurat e licencimit dhe mbikëqyrjes së instituteve private të pensioneve</p>	<p>Vendimi përcakton dokumentacionin e nevojshëm për përfitimim e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat pensionesh, kushtet për dhënien dhe tërheqjen e lejes si dhe procedura për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar.</p>
<p>Rregullore miratuar me vendimin nr.16, datë 8.02.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Për procedurat e licencimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare</p>	<p>Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra paraqitjes së dokumentacionit për licencim si dhe procedurën e ndjekuar nga autoriteti për dhënien e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare”.</p>
<p>Rregullore miratuar me vendimin nr.15, datë 8.02.2007 të Bordit të AMF</p>	<p>Për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar të instituteve private të pensioneve suplementare</p>	<p>Qëllimi i kësaj rregulloreje është hartimi i programit të kontrollit të ushtruar nga AMF ndaj instituteve private të pensioneve suplementare, procedurat e kryerjes së kontrollit, përgatitja e raportit të kontrollit dhe përcaktimi i standardeve të kontrollit.</p>

Tregu i Sigurimeve

1. INSIG sh.a.		2. SIGMA sh.a.		3. SIGAL sh.a.		4. ATLANTIK sh.a.	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Saimir ZEMBLAKU	Qemal DISHA	Avni PONARI	Dritan ÇELAJ			
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Sigurime Jete + Jo-Jete	Sigurime Jo-Jete	Sigurime Jo-Jete	Sigurime Jo-Jete			
<i>Lloji i Pronësise</i>	Shoqëri me kapital shtetëror + kapital të huaj	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj	Shoqëri me kapital vendas			
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Dibrës" Nr. 91, Tiranë	Rr "A - Frashëri", sheshi Willson, Kútia Postare Nr. 1714, Tiranë	Bul. "Zogu I", Nr.1 , Kútia Postare Nr.2387, Tiranë	Rr. "Themistokli Gërmenji", 3/1, Tiranë			
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 234 170	+355 4 258 254, +355 4 258253	+355 4 250 220	+355 4 230 506, +355 4 235088			
<i>Faqja e Internetit</i>	www.insig.com.al	www.sigma-insurance.com	www.sigal.com.al	www.atlantik.com.al			
<i>Posta Elektronike</i>	info@insig.com	sigma_sha@insurer.com	info@sigal.com.al	atlantik@atlantik.com.al			
<i>Data e Fillimit të Aktivitetit</i>	Vendim Nr. 03 dhe 04, dt. 08.06.2000	Vendim Nr. 01, dt. 03.02.1999	Vendim Nr. 02, dt. 23.06.1999	Vendim Nr. 5, dt. 13.04.2001			
5. INTERSIG sh.a.		6. ALBSIG sh.a.		7. INTERALBANIAN sh.a.		8. EUROSIG sh.a.	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Vangjel BIRBO	Gezim HUQJ	Bardhyl MINXHOZI	Myslym NELA			
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Sigurime Jo-Jete	Sigurime Jo-Jete	Sigurime Jo-Jete	Sigurime Jo-Jete			
<i>Lloji i Pronësise</i>	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas			
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Barrikadave" Pall. 122, Ap1/1, Tiranë	Rr., "Punëtoret e Rilindjes", Nr.10, Tiranë	Zayed Business Center, Kútia Postare Nr.277/1, Tiranë	Rr "Lek Dukagjini", Nr. 5, Tiranë			
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 235614, + 355 4 232462	+355 4 254 761, +355 4 254 764	+355 4 229 551, +355 4 229578	+355 4 238 899, +355 4 223 841			
<i>Faqja e Internetit</i>		www.albsig.com.al	www.interalbanian.com	www.eurosig.al			
<i>Posta Elektronike</i>	intersig@albaniaonline.net	info@albsig.com.al	ttroqe@interalbanian.co	info@eurosig.al			
<i>Data e Fillimit të Aktivitetit</i>	Vendim Nr. 6, dt. 13.09.2001	Vendim gjykatë Nr. 30756 dt. 09.09.2004	Vendim Nr. 9, dt. 19.07.2004	20.09.2004			



9. SICRED sh.a.		10. SIGAL-LIFE sh.a.	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Genc KOXHAI	Edvin HOXHAI	
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Sigurime Jete	Sigurime Jete	
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj	
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Sami Frashëri", Pall. 20, Tiranë	Bul. "Zogu I", Pall. Diplomatëve, Nr 57, Tiranë	
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 237 549	+355 4 233 308	
<i>Faqja e Internetit</i>	www.sicred.com.al	www.sigal.com.al	
<i>Posta Elektronike</i>	contact@sicred.com.al	infolife@sigal.com.al	
<i>Data e Fillimit të Aktivitetit</i>	Vendim Nr. 9, dt. 26.07.2004	01.03.2005	

Tregu i Letrave me Vlerë

1. BANKA E TIRANËS sh.a		2. QENDRA E REGJISTRIMIT TË AKSIONEVE sh.a.		3. TRIUMF GROUP sh.a.	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Dimitris FRANGETIS	Enton SHAHAJ		Mirela ANGJELI	
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar	Regjistruues i aksioneve të shoqërive tregtare		Tregtar në bono thesari	
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital shtetëror		Shoqëri me kapital privat vendas	
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë	Rr. "Punëtorët e Rilindjes", Nr.13, Tiranë		Rr. "M. Gjollështa", Kulla 2, ap.13, Tiranë	
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 269616, +355 4 269707	+355 4 233442, +355 4 233425		+355 68 2058275 / +355 4 256081	
<i>Faqja e Internetit</i>	www.tiranabank.al				
<i>Posta Elektronike</i>	info@tiranabank.net				
<i>Dt. e Fillimit të Licenc.</i>	05.11.2002	05.11.2002		24.11.2003	
<i>Dt. e Mbarimit të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat		Pa afat	

4. BALLKAN GROUP-01 sh.a.		5. BANKA POPULLORE sh.a		6. BURSA E TIRANËS sh.a	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Genci RAMAJ	Edvin LIBOHOVA	Anila FURERAJ		
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë	Tregtar	Tregtar	Treg i organizuar letrash me vlerë	
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital privat vendas	Shoqëri me kapital privat vendas	Shoqëri me kapital shtetëror	Shoqëri me kapital shtetëror	
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Reshit Çollaku", Pall. 7-katësh tek Shallvaret, shk.2/6. Tiranë	Rr. "Domika Kastrioti", Nr.11/1, Tiranë	Rr. "Dora D'Istria", Nr.2, Kutia Postare 274/1, Tiranë		
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 233537, +355 4 233537	+355 4 272790/1, +355 4 272781	+355 4 265 058		
<i>Faqja e Internetit</i>		www.bpopullore.com	www.tse.com.al		
<i>Posta Elektronike</i>		info@bpopullore.com	tseinfo@abcom-al.com		
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>	24.11.2003	23.03.2005	01.07.2005		
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat	01.07.2007		

7. RAIFFEISEN BANK sh.a		8. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË sh.a		9. BANKA KOMBËTARE TREGTARE sh.a	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Steven GRUNERUD	Lorenzo RONCARI	Seyhan PENCAPLIGIL		
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar dhe Regjistrues i letrave me vlerë të Qeverisë në Shqipëri	Tregtar dhe Regjistrues i letrave me vlerë të Qeverisë në Shqipëri	Tregtar dhe Regjistrues i letrave me vlerë të Qeverisë në Shqipëri		
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital të huaj		
<i>Adresa e Selisë</i>	European Trade Center, Bul. "Bajram Curri", Tiranë	Rr. "Ismail Qemali", Nr. 27, Tiranë	Bul. "Zhan D'ark", Tiranë		
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 224540, +355 4 230013	+355 4 248753/4/5/6/7, +355 4 220160	+355 4 250955, +355 4 250956		
<i>Faqja e Internetit</i>	www.raiffeisen.al	www.ambankalb.com	www.bkt.com.al		
<i>Posta Elektronike</i>		americanbank@ambankalb.com	info@bkt.com.al		
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>	28.09.2005	24.11.2005	21.12.2005		
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat		



10. ALPHA BANK - Tirana sh.a		11. BANKA CREDINS sh.a		12. BANKA ITALO-SHQIPTARE sh.a	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Andreas GALATOULAS	Artan SANTO	Luigi MASTRAPASQUA		
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar dhe Regjistrues i bonove të thesarit	Tregtar dhe Regjistrues i bonove të thesarit	Tregtar i bonove të thesarit		
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital privat vendas	Shoqëri me kapital të huaj		
<i>Adresa e Selisë</i>	Bul. "Zogu I", Nr. 47/1, Tiranë	Rr. "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë	Rr. "Barrikadave", Nr.1, Tiranë		
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 240 478, +355 4 232102	+355 4 234096, +355 4 258752	+355 4 233966, +355 4 235700		
<i>Faqja e Internetit</i>		www.bankcredins.com	www.bia.com.al		
<i>Posta Elektronike</i>		info@bankcredins.com	biatia@bia.com.al		
<i>Dt. e Fillimit të Licenc.</i>	13.02.2006	08.05.2006	08.05.2006		
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat	08.05.2007		

Fondet e Pensioneve Private Suplementare

1. Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë		2. GARANTSIG Instituti Privat i Pensioneve		3. CAPITAL Instituti Privat i Pensioneve	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Arjan KRAJA	Kiço LOLI	Themistokli ADHAMI		
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Fond Privat Pensionesh Suplementare	Fond Privat Pensionesh Suplementare	Fond Privat Pensionesh Suplementare		
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital privat vendas + kapital të huaj	Shoqëri me kapital privat vendas	Shoqëri me kapital privat vendas		
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Mustafa Matohiti", P.11 katësh, kati 2, zyra 1, Tiranë	Sheshi Skenderbej - Hotel "Tirana International", Kati 14, Tiranë	Rr. "Dervish Hima", Nr.2/1, Tiranë		
<i>Tel./Faks</i>	+ 355 4 240 207/8	+355 4 265 521, + 355 4 265 044	+ 355 4 348 000, + 355 4 363 003		
<i>Faqja e Internetit</i>	www.apfa.com.al	www.garantsig-al.com	www.capital.com.al		
<i>Posta Elektronike</i>	info@apfa.com.al	garantsig-al@abisnet.com	contact@capital.com.al		
<i>Data e Fillimit të Aktivitetit</i>	01.01.2006	01.01.2006	01.03.2006		

SHTOJCA D: Tabelat Statistikore



Treguesit Kryesore Makro-Ekonomikë 1996 - 2006

Treguesit e Përgjithshëm	Njësia matjes	Treguesit e Përgjithshëm										
		1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Popullsia	000	3.076	3.075	3.055	3.054	3.061	3.074	3.094	3.111	3.127	3.142	3.159
Te punësuar gjithsej	000	1.116	1.107	1.085	1.065	1.068	921	921	927	931	932	934
Te papunë të regjistruar	000	158	194	235	240	215	181	173	164	157	154	150
Papunësia	%	12,3	14,9	17,7	18,4	16,8	16,4	15,8	15,0	14,4	14,2	13,8
Produkti i Brendshëm	mln Lekë	351.113	353.642	417.009	480.581	532.977	590.282	628.527	694.018	752.367	822.035	899.700
	rritja (%)	0,7	17,9	15,2	10,8	10,9	10,8	6,5	10,4	8,4	9,3	9,4
	mln US \$	3.360	2.375	2.768	3.490	3.709	4.114	4.485	5.695	7.320	8.232	9.170
	rritja (%)	-29,3	16,6	26,1	6,3	10,9	9,0	27,0	28,5	12,5	11,4	
Bruto (PBB)	mln Euro			3.270	4.595	4.749	5.047	5.893	6.619	7.310		
	rritja (%)			22,9	14,3	3,3	6,3	16,8	12,3	10,4		
Rritja reale e PBB-së	%	9,1	-10,9	8,6	13,2	6,5	7,1	4,3	5,8	6,2	5,6	5,0
	Lekë	114.165	115.013	136.487	157.371	174.124	192.043	203.177	223.071	240.603	261.628	284.805
	rritja (%)	0,7	18,7	15,3	10,6	10,3	5,8	9,8	7,9	8,7	8,9	
PBB për frymë	US\$	1.092,5	772,3	906,0	1.142,9	1.211,6	1.338,5	1.449,7	1.830,6	2.341,0	2.619,9	2.903
	rritja (%)	-29,3	17,3	26,1	6,0	10,5	8,3	26,3	27,9	11,9	10,8	
	Euro			1.070,8	1.313,4	1.494,8	1.535,0	1.622,2	1.884,6	2.106,7	2.314,2	
	rritja (%)			22,6	13,8	2,7	5,7	16,2	11,8	9,8		
Inflacioni												
Mesatar vjetor	%	33,2	32,1	20,9	0,4	0,0	3,1	5,2	2,2	2,9	2,4	2,4
Fund i periudhës	%	17,4	42,1	8,7	-1,0	4,2	3,5	1,7	3,3	2,2	2,0	2,5

Treguesit e Financave Pulike

Treguesit	Njësia matjes	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Totali i të Ardhurave	milion Leke	52.294	58.949	102.524	123.161	130.643	145.639	154.595	167.224	184.356	204.163	226.283
	rritja (%)`		12,7	73,9	20,1	6,1	11,5	6,1	8,2	10,2	10,7	10,8
	% e PBB	14,9	16,7	24,6	25,6	24,5	24,7	24,6	24,1	24,5	24,8	25,2
Të Ardhurat Tatimore	milion Leke	45.579	72.576	72.576	83.566	104.112	114.294	128.948	145.388	165.974	183.816	205.514
	rritja (%)		59,2	17,4	15,1	24,6	9,8	12,8	12,7	14,2	10,7	11,8
	% e PBB	12,9	17,4	17,4	17,4	19,5	19,4	20,5	20,9	22,1	22,4	22,8
Totali i Shpenzimeve	milion leke	87.596	100.730	141.628	165.692	170.620	186.049	192.517	201.152	222.439	232.339	254.762
	rritja (%)		15,0	40,6	17,0	3,0	9,0	3,5	4,5	10,6	4,5	9,7
	% e PBB	24,9	28,5	34,0	34,5	32,0	31,5	30,6	29,0	29,6	28,3	28,3
Investimet	milion Lekë		13.859	24.215	34.120	36.274	43.397	37.925	31.472	38.266	38.375	47.502
	rritja (%)			74,7	40,9	6,3	19,6	-12,6	-17,0	21,6	0,3	23,8
	% e PBB		3,9	5,8	7,1	6,8	7,4	6,0	4,5	5,1	4,7	5,3
Deficiti i Përgjithshëm	milion Lekë	-35.302	-41.781	-39.104	-42.531	-39.977	-40.410	-37.922	-33.928	-38.083	-28.176	-28.479
	% e PBB	-10,1	-11,8	-9,4	-8,8	-7,5	-6,8	-6,0	-4,9	-5,1	-3,43	-3,17
Borxhi i Brendshëm	milion Lekë	82.785	120.527	149.439	177.490	226.069	241.161	260.752	280.767	295.200	327.353	348.936
	% e PBB	23,6	34,1	35,8	36,9	42,4	40,9	41,5	40,5	39,2	39,8	38,8
Borxhi i Jashtëm	Milion \$	323,4	347,5	460,5	550,1	617,0	697,7	979,6	1.200,4	1.389,9	1.356,1	1.553,3
	% e PBB	9,6	14,6	16,6	15,8	16,6	17,0	21,8	21,1	19,0	16,5	16,9

Burimi: Ministria e Financave dhe INSTAT

Treguesit e Tregtisë së Jashtme

Treguesit	Njësia matjës	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Bilanci Tregtar	Milion \$	-678,3	-534,9	-603,7	-662,8	-821,0	-1.027,0	-1.155,2	-1.336,3	-1.591,6	-1.887,0	-1.953,0
	% e PBB	-20,2	-22,5	-21,8	-19,0	-22,1	-25,0	-25,8	-23,5	-21,7	-22,9	-21,3
Eksporti	Milion \$	243,7	158,6	208,0	275,1	255,4	304,6	330,2	447,1	603,3	652	721
	rritja (%)	19,0	-34,9	31,1	32,3	-7,2	19,3	8,4	35,4	34,9	8,1	10,6
Importi	% e PBB	7,3	6,7	7,5	7,9	6,9	7,4	7,4	7,9	8,2	7,9	7,9
	Milion \$	922,0	693,5	811,7	937,9	1.076,4	1.331,6	1.485,4	1.783,4	2.194,9	2.539	2.674
Importi	rritja (%)	35,6	-24,8	17,0	15,5	14,8	23,7	11,6	20,1	23,1	15,7	5,3
	% e PBB	27,4	29,2	29,3	26,9	29,0	32,4	33,1	31,3	30,0	30,8	29,2
Bilanci i Llogarisë Korrente	Milion \$	-62,3	-253,7	-65,0	-132,9	-163,1	-217,9	-420,8	-406,7	-358,2	-576,2	-770,3
	% e PBB	-1,9	-10,7	-2,3	-3,8	-4,4	-5,3	-9,4	-7,1	-4,9	-7,0	-8,4
Investimet e Huaja Direkte	Milion \$	90,1	47,5	45,0	41,2	143,0	207,3	135,0	178,0	341,3	238,7	293,5
	% e PBB	2,7	2,0	1,6	1,2	3,9	5,0	3,0	3,1	4,7	2,9	3,2
Transfertat	Milion \$	559,4	264,4	523,9	353,0	533,0	570,5	613,2	842,0	1.109,4	1.014	1.065
	Milion \$	306,0	384,0	482,0	608,0	754,0	860,0	1.026,0	1.374,0	1.390	1.536	
Rezervat	Milion \$	3,5	3,7	3,8	4,2	4,6	4,6	4,4	3,9	4,0	4,1	4,2
	Lek/US\$	104,50	148,93	150,64	137,69	143,71	143,48	140,15	121,86	102,78	99,86	98,11
Kursi i këmbeimit	Lek/Euro	146,96	132,58	128,47	128,47	128,47	128,47	132,36	137,51	127,67	124,19	123,07

Burimi: Ministria e Financave dhe INSTAT


Agregatët Monetarë

Treguesit	Njësia matjës	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Agregati M1	milion Lekë	90.406	91.667	83.729	103.004	124.041	142.926	152.741	144.730	172.833	227.684	227.500
	Në %	1,4	-8,7	23,0	20,4	15,2	6,9	-5,2	19,4	31,7	-0,1	
Agregati M2	milion Lekë	120.646	162.221	199.264	239.662	264.497	305.302	324.727	349.513	391.411	426.150	480.500
	Në %	34,5	22,8	20,3	10,4	15,4	6,4	7,6	12,0	8,9	12,8	
Agregati M3	milion Lekë	154.553	198.547	239.526	292.871	328.101	394.316	416.685	448.427	507.206	578.036	650.600
	Në %	28,5	20,6	22,3	12,0	20,2	5,7	7,6	13,1	14,0	12,6	

Burimi: Ministria e Financave dhe INSTAT



Ecuria e Disa Treguesve të Rëndësishëm Makro-Ekonomikë (1996-2007)






BTH 6 Mujore viti 2006

Muajt	Interesi i Depozitave	Yieldi i BTH	Norma e Inflacionit
Janar	4,95%	6,72%	1,38%
Shkurt	4,71%	6,33%	1,35%
Mars	4,80%	5,95%	1,50%
Prill	4,60%	5,62%	2,37%
Maj	4,46%	5,48%	3,08%
Qershor	4,35%	5,43%	2,43%
Korrik	4,23%	5,49%	3,25%
Gusht	4,26%	5,72%	2,82%
Shtator	4,31%	6,24%	2,55%
Tetor	4,50%	6,68%	2,25%
Nëntor	4,51%	6,86%	2,91%
Dhjetor	4,64%	7,06%	2,51%

6 Mujore



BTH 12 Mujore viti 2006

Muajt	Interesi i Depozitave	Yieldi i BTH	Norma e Inflacionit
Janar	4,95%	6,72%	1,38%
Shkurt	4,71%	6,33%	1,35%
Mars	4,80%	5,95%	1,50%
Prill	4,60%	5,62%	2,37%
Maj	4,46%	5,48%	3,08%
Qershor	4,35%	5,43%	2,43%
Korrik	4,23%	5,49%	3,25%
Gusht	4,26%	5,72%	2,82%
Shtator	4,31%	6,24%	2,55%
Tetor	4,50%	6,68%	2,25%
Nëntor	4,51%	6,86%	2,91%
Dhjetor	4,64%	7,06%	2,51%

12 Mujore

